



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 12 regjistër (JR)
Datë 04.03.2020

Nr. 1 i vendimit
Datë 27.01.2022

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Ardian Hajdari	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 27.01.2022, ora 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Branko Hrvatin, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 12/2020 (JR), datë 04.03.2020, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 224, datë 20.12.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Astrit Kalaja.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 224, datë 20.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Astrit Kalaja dhe shkarkimin e tij nga detyra, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dëgjoi subjektin e rivlerësimit dhe avokatin e tij, z.

Viktor Gumi, të cilët përfundimisht kërkuan lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit prej vitit 1993 e në vijim ka ushtruar detyrën e gjyqtarit dhe në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Shkodër, për rrjedhojë ai gëzonte statusin e magjistratit¹. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor², në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë³, deklaratën për kontrollin e figurës⁴, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional⁵.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin.*
 - (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
 - (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - (iv) *Nuk ka kryer deklarim të rremë.*
 - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Në raportin e saj, DSIK-ja përcaktoi se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë, të plotë dhe në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, dhe se lidhur me të administrohen informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, kryesisht atë të korrupsionit aktiv apo pasiv për

¹ Neni 2, pika “gj” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se magjistrat është edhe gjyqtari, ndërkohë neni 164, pika 2 e të njëjtit ligj parashikon se gjyqtarët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar sipas të njëjtit ligj, vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit.

² Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

³ Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 27.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 27.01.2017. Të njëjtën datë mban dhe deklarata e pasurisë në rubrikën përkatëse.

⁴ Referuar raportit mbi kontrollin e figurës, të përgatitur nga Grupi i Punës pranë DSIK-së.

⁵ Referuar raportit nr. {***} prot., datë 19.03.2019, të Inspektoratit pranë KLD-së për “Analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Astrit Kalaja për periudhën 08.10.2013 deri më 08.10.2016”, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 24.01.2017.

shkak të funksionit të tij. Grupi i punës, pasi vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Astrit Kalaja ishte person i mundshëm për t'u vënë nën presion nga struktura kriminale, sipas përcaktimit të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, konstatoi papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.

5. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Inspektorati i KLD-së, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin në fjalë, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke marrë vendimin nr. 224, datë 20.12.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 224, datë 20.12.2019, vendosi: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, rivlerësuar në funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

8.1 *Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit, në mënyrë të detajuar sipas viteve, janë konsideruar dhe përlogaritur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe në bazë të tyre është vlerësuar mjaftueshmëria e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara nga Komisioni, me të ardhura nga burime të ligjshme, sipas nenit “D” të Aneksit të Kushtetutës. Në këtë analizë financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2003, [...], nga ku, pasi janë konsideruar si të disponueshme shumat e përdorura për blerjen e pasurive nr. 1 dhe 2 – siç është arsyetuar në paragrafët përkatës – ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mangësi financiare të papërfillshme dhe, për rrjedhojë, analiza financiare përfundimtare (e riparë pas shpjegimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit), në rastin konkret, nuk paraqet shkaqe të mjaftueshme për aplikimin e masës së parashikuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84.2016.*

8.2 *Në lidhje me kontrollin e figurës, Komisioni – pas hetimit administrativ dhe rivlerësimit të kryer, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, dhe bazuar në provat dhe dokumentet e administruara, si dhe mbi dokumentet dhe 20 informacionet e klasifikuara, të verifikuara nga trupi gjykues pranë organeve ligjzbatuese – në vlerësimin e çështjes në tërësi në lidhje me kriterin e figurës, arrin në përfundimin se në raportin e dërguar nga DSIK-ja, vlerësimi i kryer nuk përmban rrethana bindëse, të mjaftueshme për të konkluduar për ndonjë favorizim apo ndikim të paligjshëm nëpërmjet funksionit të tij, apo për konstatimin e ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme me ndonjë person të përfshirë në krimin e organizuar. Gjithashtu, informacionet dhe dyshimet e ngritura mbi*

veprime korruptive (të përsëritura), nuk rezultojnë të provuara/bazuara, për të konkluduar bindshëm mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në to. Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk i konsideron të mjaftueshme informacionet, indiciet dhe dyshimet e ngritura për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e funksionit të tij. Për rrjedhojë, konstatimet e mësipërme nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit – sipas pikës 2 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

8.3 *Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, nga kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se të dhënat e nxjerra nga disa prej dosjeve të administruara nga Komisioni, si dhe konstatimet e bëra lidhur me mënyrën e të punuarit (modus operandi) të subjektit, problematikat që kanë rezultuar nuk mund të klasifikohen si shkelje apo mangësi të rënda profesionale. Në këto rrethana, trupi gjykues çmon se përfundimet e sipërcituara nuk përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për të konkluduar për papërshtatshmërinë profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe, si rrjedhim, mbërrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, ka arritur së paku nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit ligjor që e përcakton atë si prag kualifikimi.*

III. Shkaqet e ankimit

9. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, më datë 06.02.2020, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 224, datë 20.12.2019, për subjektin e rivlerësimit Astrit Kalaja, duke pretenduar se në vendimin objekt ankimi evidentohen dhe parashtrohen rrethana dhe fakte ligjore, lidhur me: (i) pasaktësi dhe pamjaftueshmëri në deklarinë e subjektit për dy pasuri të paluajtshme, të llojit “apartament banimi” dhe “tokë arë”, si dhe deklarime të pasakta/pamjaftueshme lidhur me posedimin e likuiditeteve *cash* ndër vite nga ana e subjektit, që kanë shërbyer si burim për blerjen e këtyre pasurive; (ii) mosdeklarimin nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të marrëdhënies financiare (hua) me z. Rr. P., si dhe mosdeklarimin e shlyerjes së kësaj huaje; (iii) mundësinë financiare të huadhënësit, z. Rr. P., për të mbuluar me burime të ligjshme huan e dhënë subjektit të rivlerësimit në shumën e 3.300.000 lekëve; (iv) pamjaftueshmërinë financiare të subjektit të rivlerësimit për blerjen e dy pasurive të paluajtshme, të llojit “apartament banimi” dhe “tokë arë”.
10. Komisioneri Publik kundërshtoi vendimin e Komisionit pasi vlerësoi se, lidhur me faktet dhe provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit për subjektin Astrit Kalaja, referuar jurisprudencës së Kolegjit, sipas tij subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë sipas nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe në përfundim të gjykimit, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:
 - ° *ndryshimin e vendimit nr. 224, datë 20.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Kalaja.*
11. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
 - 11.1. *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarinë të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 109,5 m², me vendndodhje në lagjen “{***}”, Shkodër, pasi sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, huan e marrë në vlerën prej 3.000.000 lekësh nga z. Rr. P. dhe detyrimin ndaj këtij të fundit deri në kthimin e shumës, si dhe nuk mbulonte me burime të*

ligjshme pagesën e kështit të dytë të apartamentit, në vlerën prej 1.700.000 lekësh në vitin 2009 dhe shlyerjen e parakohshme të kredisë në vitin 2010, në vlerën prej 2.000.000 lekësh.

11.2. *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “tokë arë” me sip. 379 m², me vendndodhje {***}-Plazh, Shkodër, pasi sipas Komisionerit Publik, ai nuk mbulonte me burime të ligjshme blerjen e kësaj pasurie në vitin 2013, në vlerën prej 1.800.000 lekësh.*

IV. Kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit

- 12.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 19.02.2020⁶, i është drejtuar Kolegjit me *Kundërankim* ndaj ankimit të Komisionerit Publik. Kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit ndaj shkaqeve të ankimit, sipas kundërankimit dhe parashtrësive të tij para Kolegjit, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

12.1. Lidhur me shkakun e ankimit sipas paragrafit 11.1 më sipër, subjekti i rivlerësimit prapësoi se ka pasur burime të mjaftueshme financiare për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme, duke identifikuar të ardhurat e deklaruara nga shitja e apartamentit me sip. 63 m² në vitin 2008 në shumën prej 3.500.000 lekësh, shumë e cila fillimisht ka qenë e depozituar në Bankën Raiffeisen, dhe pas tërheqjes në vitin 2008 nga subjekti i rivlerësimit, pretendohet të jetë mbajtur prej tij në gjendje *cash* në banesë. Lidhur me konstatimin e Komisionerit Publik për mosdeklarimin e huas së marrë z. Rr. P., subjekti kundërshtoi se mes tij dhe z. P. nuk është krijuar asnjë marrëdhënie huaje dhe, për rrjedhojë, ai pretendoi të mos ketë qenë në kushtet e detyrimit për deklarin. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi gjithashtu si të pabazuar edhe konstatimin e Komisionerit Publik mbi pamundësinë financiare të z. Rr. P. për të mbuluar me burime të ligjshme huan e dhënë subjektit, në vlerën prej 3.300.000 lekësh.

12.2. Lidhur me shkakun e ankimit sipas paragrafit 11.2 më sipër, subjekti i rivlerësimit prapësoi se ka pasur burime të mjaftueshme financiare për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme, duke qenë se për këtë qëllim ka përdorur gjendjen e likuiditetit *cash* të krijuar si pasojë e tërheqjeve nga llogaria e pagës, si dhe e kredisë së alokuar pranë Bankës Raiffeisen.

12.3. Subjekti në tërësi lidhur me kursimet e tij në gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, argumentoi se në deklarinet e tij lidhur me gjendjen *cash* nuk janë përfshirë dhe pasqyruar në deklarinat periodike gjendjet në *cash* të krijuara nga tërheqjet e kredive nga Banka Raiffeisen dhe Banka Kombëtare Tregtare (në vijim referuar “BKT”), si dhe nga të ardhurat e fituara nga shitja e apartamentit në lagjen “{***}” në Shkodër, të cilat janë konsumuar për blerjen e apartamentit në lagjen {***}, për blerjen e një sipërfaqeje toke të ndodhur në Velipojë, për shlyerjen e kredive e ndonjë shërbim tjetër, me justifikimin se ato janë të deklaruara një herë si burim të ardhure kur janë deklaruar shitjet e banesave dhe alokimi i kredive. Subjekti pretendoi se të njëjtën logjikë veprimi ka ndjekur edhe në lidhje me pakësimet e këtyre likuiditeteve duke qenë se i ka konsideruar të deklaruara pakësimet e tyre në momentin kur ka deklaruar përmbushjen e detyrimeve ndaj të tretëve.

- 13.** Parashtrimet e tij para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit i shoqëroi me disa akte shkresore të cilat kërkoi nga trupi gjykues të administrohen në cilësinë e provave. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit dhe avokati i tij, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a”, kërkuan lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 224, datë 20.12.2019.

⁶ Protokolluar në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2020.

V. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

14. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit Astrit Kalaja, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

15. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁷ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

16. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 224, datë 20.12.2019, për subjektin e rivlerësimit Astrit Kalaja, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve.
17. Në vijim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit drejtuar trupit gjykues për marrjen në cilësinë e provave të akteve shkresore të depozituara së bashku me parashtrimet e tij, trupi gjykues, pasi dëgjoi edhe Komisionerin Publik lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me vendim të ndërmjetëm⁸ vendosi të pranojë të merren në cilësinë e provës aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

18. Lidhur me shkakun e ankimit për deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 109,5 m², me vendndodhje në lagjen “{***}”, Shkodër, trupi gjykues konstatoi sa më poshtë.

⁷ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 224, datë 20.12.2019, për rivlerësimin e subjektit Astrit Kalaja, i është njoftuar Institucionit të Komisionerit Publik më datë 22.01.2020, me shkresën nr. 8010/3 prot., të së njëjtës datë, konfirmuar sipas lajmërim-marrjes së nënshkruar nga J. Z., kurse ankimi i Komisionerit Publik është depozituar pranë Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 06.02.2020, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 06.02.2020, që rezulton të jetë dita e 15-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

⁸ Shih procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 25.01.2022.

19. Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e kësaj pasurie gjatë procesit të rivlerësimit, ka arritur në konkluzionin se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë bindëse dhe se ai ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie. Ndërsa pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike të vitit 2007 lidhur me mosdeklarimin e detyrimit ndaj z. Rr. P., si dhe pasaktësitë në deklaratën periodike të vitit 2008, lidhur me mosdeklarimin në formën e kërkuar të likuiditetit gjendje në *cash* të shumës prej 3.500.000 lekësh, të tërhequra nga Banka Raiffeisen gjatë të njëjtit vit, i ka vlerësuar si pasaktësi që nuk mund të çojnë në aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.

1.28 Lidhur me burimet financiare të shtetasit Rr. P., Komisioni i ka vlerësuar si të mjaftueshme për të justifikuar shumën prej 3.300.000 lekësh – të derdhura prej tij në bankën kredidhënëse, për garancinë financiare të kësaj të fundit – pasi pozicioni i tij financiar është provuar jo vetëm me gjendjet në llogaritë e tij bankare, por kryesisht me të ardhurat e konsiderueshme të realizuara nga shitja e një prone në vitet e mëparshme, me çmim 28.500.000 lekë [...].

1.31 Në vijim të argumentimeve të mësipërme, trupi gjykues çmon se ndonëse rrethanat e sipërcituara çojnë në moscilësimin e marrëdhënies financiare që është duke u analizuar, si një hua, në kuptimin e nenit 1050 të Kodit Civil – fakt ky që e lehtëson disi pozitën e subjektit të rivlerësimit lidhur me mosdeklarimin e saj si një veprim/burim. Por nga momenti që marrëdhënia në fjalë ka sjellë përfitime/lehtësime të subjektit dhe ka gjeneruar, gjithsesi, një detyrim të subjektit ndaj z. Rr. P. për të kthyer te ky i fundit shumën prej 3.300.000 lekësh, pasi të përfundonte nevoja e garancisë financiare, subjekti duhej që të kishte deklaruar ekzistencën e këtij detyrimi financiar në faqet 5 dhe 6 të deklaratës periodike vjetore të vitit 2007, si dhe shuarjen e tij në periudhën përkatëse. Trupi gjykues çmon se nisur nga rrethanat specifike, nga fakti që veprimi financiar është pasqyruar qartësisht në përshkrimin e veprimit bankar, mosdeklarimi i detyrimit në fjalë, në këtë rast përbën një pasaktësi që nuk mund të çojë në aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

*1.32 Lidhur me deklaratimet e subjektit për gjendjen *cash* ndër vite dhe për ndërthurjen e tyre me zotërimin ose jo të disa shumave që subjekti i rivlerësimit i kishte përfutuar nga shitja e pasurisë, i kishte depozituar në llogari bankare dhe më pas i kishte tërhequr, Komisioni evidenton faktin se në analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, janë përllogaritur vetëm shumat e deklaruara nga subjekti si *cash* në banesë, të cilat kanë rezultuar të mbuluara nga burime financiare të ligjshme – vetëm nga puna e subjektit dhe bashkëshortes – të verifikuara përgjatë viteve përkatëse [...].*

*1.34 Për sa u përket shumave prej 2.000.000 dhe 1.500.000 lekësh, të tërhequra nga subjekti prej llogarisë bankare në vitin 2008, të cilat ishin depozituar pas shitjes së një apartamenti në vlerën 3.500.000 lekë, në vitin 2007 – nga ku buronin – lidhur me pretendimin e subjektit se ato kanë qenë në disponibilitetin e tij në gjendjen *cash* në fund të vitit 2008 dhe në vitin 2009, deri në momentin e përdorimit të tyre – por subjekti nuk i ka deklaruar si *cash*, pasi ishin rregullisht të deklaruara si të ardhura vjetore (nga shitja e apartamentit) në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 dhe të dokumentuara nga dokumentet bankare si tërheqje, trupi gjykues – për shkaqet e mëposhtme – i gjen bindëse shpjegimet e subjektit, por njëkohësisht e konsideron si të pasaktë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, në pjesën e deklarimit *cash*, për mospërfshirjen e shumës në fjalë (si gjendje *cash* në dispozicion më 31.12.2008) [...]. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se duhet të konsiderohet me burim financiar të ligjshëm e gjithë pagesa e kështit të dytë për blerjen e apartamentit në vitin 2009 – dhe për pasojë të gjitha shumat e paguara nga subjekti për këtë pasuri (nr. 1) rezultojnë të mbuluara me burime financiare të ligjshme – për faktin se disponibiliteti i*

shumave të arsyetuara në pikat e mësipërme i mbulon mangësitë e konstatuara në analizën financiare paraprake. [...]

20. Komisioneri Publik kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me pasurinë objekt kontrolli, me pretendimin se ai nuk mbështetet në një vlerësim të drejtë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të dala nga aktet e administruara në dosje, si dhe nuk është në harmoni me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit. Sipas Komisionerit Publik, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm pasi nuk ka deklaruar marrëdhënien financiare me z. Rr. P., nuk ka provuar mundësinë financiare të këtij të fundit për të mbuluar me burime të ligjshme huan e dhënë, si dhe nuk mbuloi me burime të ligjshme shlyerjen e këstit të dytë dhe shlyerjen e parakohshme të kredisë në BKT. Këtë shkak të ankimit të tij, Komisioneri Publik e mbështet në pretendimet dhe argumentet e mëposhtme.

20.1. Në lidhje me shumën prej 3.300.000 lekësh, të dhënë nga z. Rr. P. për t'u përdorur nga subjekti i rivlerësimit si garanci bankare për sigurimin e kredisë së marrë, me qëllim blerjen e apartamentit të banimit, Komisioneri Publik pretendoi se, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, duke gjykuar nga natyra e veprimeve bankare dhe juridike, përmbushen të gjitha kushtet e nenit 1050 të Kodit Civil për ta konsideruar marrëdhënien e krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe z. Rr. P. (më së paku) si një marrëdhënie huaje.

20.2. Subjekti i rivlerësimit, sipas Komisionerit Publik, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar (në vijim "ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar) nuk ka deklaruar në deklaramat periodike për periudhën 2008-2013, marrëdhënien e krijuar mes palëve si më sipër cituar, vlerën e detyrimit financiar dhe shlyerjen e plotë të tij. Këtë pretendim, Komisioneri Publik shprehet se e mbështet edhe në qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit për interpretimin dhe zbatimin e neneve 30 dhe 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016⁹.

20.3. Komisioneri Publik pretendoi se deklaramet e subjektit të rivlerësimit dhe shtetasve Rr. P. dhe V. F., lidhur me burimin e krijimit të shumës 3.300.000 lekë janë kontradiktore, duke krijuar paqartësi si në drejtim të identifikimit të huadhënësit real, ashtu edhe në drejtim të verifikimit të mundësisë financiare të këtij të fundit për të mbuluar me burime të ligjshme këtë shumë.

20.4. Burimi i deklaruar si të ardhura nga shitja e "apartamentit me sip. 63 m²" në Shkodër, për pagesën e këstit të dytë të pasurisë objekt kontrolli me vlerë 1.700.000 lekë, si dhe për shlyerjen e parakohshme të kredisë së marrë nga subjekti i rivlerësimit pranë BKT-së, nëpërmjet depozitimit të shumës prej 2.000.000 lekësh në *cash*, në arkën e institucionit bankar në datën 26.03.2010, sipas Komisionerit Publik nuk justifikohet me të ardhura të ligjshme, si pasojë e mosdeklarimit të kursimeve në gjendje *cash* sipas kërkesave të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar. Këtë pretendim, Komisioneri Publik shprehet se e mbështet edhe në jurisprudencën¹⁰ e deritanishme të Kolegjit, lidhur me interpretimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës në drejtim të konceptit të

⁹ Komisioneri Publik referon në mënyrë të shprehur në ankimin e tij vendimin e Kolegjit nr. 9/2018 (JR) që i përket subjektit A. Xh., vendimin nr. 5/2019 (JR) që i përket subjektit A. C. dhe vendimin nr. 19/2019 (JR) që i përket subjektit Xh. Z.

¹⁰ Komisioneri Publik referoi në ankimin e tij dhe gjatë parashtrësive në Kolegj vendimin e Kolegjit nr.7/2019 (JR) që i përket subjektit E. S., vendimin nr. 11/2019 (JR) që i përket subjektit E. I., vendimin nr. 19/2019 (JR) që i përket subjektit Xh. Z., vendimin nr. 20/20 (JR) që i përket subjektit G. O., vendimin nr. 29/2019 (JR) që i përket subjektit F. Q. dhe vendimin nr. 13/2021 (JR) që i përket subjektit A. M.

pasurisë së ligjshme, të ndërlidhur me momentin e deklarimit të likuiditeteve në deklaratat periodike vjetore.

21. Lidhur me këtë shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit në kundërankimin e tij, si dhe në parashtrimet para Kolegjit, argumentoi se pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me pasurinë objekt kontrolli janë të pabazuara. Ai prapësoi se ka pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendoi se:

21.1. Të ardhurat e krijuara në vitin 2008, në vlerën e 3.500.000 lekëve nga shitja e apartamentit me sip. 63 m², të cilat janë deklaruar si burim për blerjen e apartamentit me sip. 109,5 m², janë tërhequr prej tij nga llogaria bankare pranë Bankës Raiffeisen ku u depozituan fillimisht nga blerësi dhe janë mbajtur nga subjekti i rivlerësimit në banesë. Subjekti pretendoi se në deklaratën periodike të vitit 2008, deklarimi i shumës në *cash* përfaqëson kursimin e realizuar në vitin 2008, d.m.th. vetëm shtesën për atë vit dhe jo gjendjen në tërësi të likuiditetit *cash* në shtëpi. Nga përlllogaritjet e kryera si më sipër, sipas subjektit të rivlerësimit rezultoi se ai ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të përballuar të gjithë vlerën e kësaj të dytë të çmimit të apartamentit, në vlerën prej 1.700.000 lekësh, dhe shlyerjen e kredisë në vitin 2010, në vlerën prej 2.000.000 lekësh.

21.2. Subjekti kundërshtoi gjithashtu edhe konstatimin e Komisionerit Publik për mosdeklarim të marrëdhënies së huas së krijuar mes tij dhe z. Rr. P., me pretendimin se nuk e ka pasur një detyrim të tillë, pasi mes tyre nuk ka ekzistuar asnjë marrëdhënie huaje. Sipas subjektit të rivlerësimit, shuma prej 3.300.000 lekësh nuk është konsideruar si hua, pasi kjo shumë nuk është përdorur asnjëherë prej tij. Subjekti argumentoi se shuma në fjalë ka qenë e bllokuar nga banka, si kolateral financiar për garantimin e kredisë së marrë prej tij dhe, në këtë kuptim, ka qenë thjesht një mjet sigurimi për ekzekutimin e detyrimit nga ana e subjektit të rivlerësimit. Subjekti arsyetoi se, referuar interpretimit të dispozitave ligjore të Kodit Civil që rregullojnë mjetet e garantimit të detyrimit, në raport me deklaratën noteriale të z. Rr. P., referuar jo vetëm përmbajtjes së saj por edhe shkaqeve për të cilat është iniciuar ky veprim, ndodhemi përpara një veprimi juridik pengu, për shkak se shuma është derdhur në favor të bankës dhe nuk është poseduar as nga z. P., as nga subjekti, pavarësisht se banka e ka vendosur këtë shumë në llogarinë e këtij të fundit. Subjekti sqaroi se si pasojë e vlerësimit të sa më sipër, ai nuk ka deklaruar as pagesat e kryera për kthimin e shumës së kolateralit z. Rr. P., duke qenë se ato nuk janë konsideruar prej tij si detyrim financiar.

21.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi edhe konstatimin e Komisionerit Publik mbi pamundësinë financiare të z. Rr. P. për të mbuluar me burime të ligjshme huan e dhënë subjektit në vlerën e 3.300.000 lekëve dhe pretendoi se ai ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e shumës së përdorur si kolateral financiar lidhur me kredinë e marrë prej subjektit, si pasojë e të ardhurave të krijuara nga shitja e një birrarie, në qendër të Shirokës, në vitin 1996.

22. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstatoi fillimisht që pretendimet e Komisionerit Publik lidhen me: (i) vlerësimin juridik të marrëdhënies së krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe z. P., si pasojë e depozitimit prej këtij të fundit në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, të shumës *cash* prej 3.300.000 lekësh, si një marrëdhënie huaje dhe implikimet ligjore lidhur me mosdeklarimin nga ana e subjektit të rivlerësimit të kësaj marrëdhënieje dhe detyrimeve respektive në deklaratimet periodike përpara ILDKPKI-së; (ii) vlerësimin e mundësisë financiare të z. Rr. P. për të mbuluar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua në vlerën 3.300.000 lekë; si dhe me (iii) trajtimin e të ardhurave të krijuara nga shitja e apartamentit me sip. 63 m² në Shkodër, në vitin 2007, në vlerën e 3.500.000 lekë, në kuadër të standardeve të vendosura nga Kolegji në

drejtim të deklaramit të kursimeve në formën e likuiditeteve në gjendje *cash*, për sa kohë kjo shumë është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim për shlyerjen e kështit të dytë të blerjes së apartamentit me sip. 109,5 m² në vitin 2009, si dhe shlyerjes së parakohshme të kredisë pranë BKT-së, në vitin 2010, të marrë nga subjekti i rivlerësimit në funksion të pagesës së çmimit të këtij apartamenti.

23. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues çmoi fillimisht se në kuadër të legjislacionit të zbatueshëm për deklarimin e pasurive, interesave privatë dhe konfliktit të interesit, marrëdhënia financiare e krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe z. Rr. P., si dhe detyrimet që i kanë lindur subjektit të rivlerësimit si pasojë e kësaj marrëdhënieje, pavarësisht nëse vlerësohet apo jo kjo marrëdhënie si një hua në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, ka përbërë një interes privat me karakter pasuror, për të cilin subjekti ka pasur detyrimin për deklarim pranë ILDKPKI-së, nga momenti i krijimit deri në shuarjen e këtij interesi privat. Trupi gjykues vëren se këtë detyrim për deklarim e ka njohur edhe Komisioni në vendimin e arsyetuar, pavarësisht se mosdeklarimin nga ana e subjektit (në deklaramet periodike) e ka vlerësuar si një pasaktësi, e cila në kuadër të procesit të rivlerësimit nuk mund ta kualifikojë deklaramin e subjektit lidhur me pasurinë objekt kontrolli, si deklarim të pamjaftueshëm dhe, për rrjedhojë, nuk mund të çojë në aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
24. Ndërkohë, sa i takon çështjes nëse ndodhemi apo jo para rastit të një marrëdhënieje huaje mes palëve, trupi gjykues vlerëson se në kuadër të procesit të rivlerësimit, kjo analizë vlen të kryhet në drejtim të mundësisë/afhtësisë së marrëdhënies së huas për të prodhuar pasoja konkrete në analizën e institucioneve të rivlerësimit lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në kuptim të së cilës merr vlerë edhe parashikimi i nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, jo vetëm në drejtim të detyrimit të subjektit të rivlerësimit dhe personit tjetër të lidhur me të për të justifikuar burimet e ligjshme të shumës së dhënë hua, por edhe për efekt të atribuimit të pasojave ligjore të deklaramit të pamjaftueshëm të pasurisë në rastet e dështimit për të përmbushur këtë detyrim ligjor. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerësoi se në shqyrtim të këtij shkakut ankimi, fokusi i analizës së institucioneve të rivlerësimit bie në verifikimin nëse huaja e marrë ka prodhuar pasoja në ekonominë familjare të subjektit të rivlerësimit (krijim pasurie, mbulim shpenzimesh/investimesh).
25. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues, në shqyrtimin e shkakut të ankimit lidhur me kontrollin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së krijimit të pasurisë “apartament banimi” me sip. 109,5 m² në Shkodër dhe me fokus të veçantë vlerësimin e marrëdhënies së krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe z. Rr. P., pasi analizoi aktet e fashikullit të përcjellë nga Komisioni, konstatoi faktet dhe rrethanat si më poshtë.
 - i. *Në drejtim të marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit me shoqërinë sipërmarrëse “{***}” ShPK*
26. Më datë 28.02.2008, subjekti i rivlerësimit ka lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK një kontratë sipërmarrjeje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., para noterit të Dhomës së Noterisë Shkodër, z. A. K., me anë të së cilës shoqëria sipërmarrëse ka marrë përsipër të ndërtojë për llogari të subjektit të rivlerësimit, një apartament banimi me sipërfaqe ndërtimore 120 m², nga të cilat sipërfaqja prej 109,5 m² është sipërfaqe e shfrytëzueshme. Palët kanë rënë dakord që çmimi për shitjen e këtij apartamenti të jetë 320 euro/m², i pagueshëm në dy këste, ku kësti i parë prej 3.000.000 lekësh është paguar nga subjekti që në mars të vitit 2007, ndërsa kësti i dytë përcaktohet në kontratë për t’u paguar deri në gjashtë muaj pas regjistrimit të apartamentit në ZVRPP Shkodër, ose me shitjen e apartamentit tjetër pronë e porositësit, e hipotekuar (bllokuar) në favor të BKT-së.

27. Më datë 29.07.2009, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “{***}” ShPK kanë lidhur një kontratë noteriale shitblerjeje pasurie të paluajtshme me nr. {***} rep., nr {***} kol., para noterit publik A. K., me anë të së cilës shoqëria “{***}” ShPK i ka kaluar subjektit të rivlerësimit pronësinë e apartamentit të banimit me sip. 109,5 m², të porositur sipas kontratës së mësipërme të sipërmarrjes, ku çmimi i shitjes në këtë kontratë është përcaktuar shprehimisht në vlerën prej 4.675.650 lekësh. Në nenin 4.2 të kësaj kontrate, konstatohet se palët kanë përcaktuar: *Blerësit i kanë likuiduar palës shitëse të gjithë vlerën e çmimit të shitjes, pagesë e cila është bërë jashtë kësaj zyre duke u paguar me dy këste: kësti i parë 3.000.000 lekë të reja, që në mars 2007, ndërsa pjesa e mbetur prej 1.675.650 lekësh është likuiduar para hartimit të kësaj kontrate.*

ii. *Në drejtim të marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit me Bankën Kombëtare Tregtare*

28. Në datën 14.02.2007, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kredimarrësit, dhe bashkëshortja e tij, znj. Valbona Kalaja, në cilësinë e dorëzantës, kanë lidhur me BKT-në një kontratë kredie me nr. {***} rep., nr. {***} kol., para noteres A. A.. Sipas kësaj kontrate, në favor të subjektit të rivlerësimit është lëvruar një kredi bankare në vlerën prej 3.000.000 lekësh, me qëllim “blerje apartamenti”. Kjo kredi, referuar nenit 9 të kontratës, është siguruar edhe me hipotekë të vendosur ndaj pasurisë së paluajtshme në pronësi të subjektit të rivlerësimit, me të dhëna: “apartament”, me sip. 63 m², me nr. pasurie {***}, e ndodhur në zonën kadastrale nr. {***}, e regjistruar në regjistrin hipotekor volumi {***}, faqe {***}, me adresë në {***}. “{***}”, rruga “{***}”, Shkodër. Në të njëjtën datë dhe para së njëjtës notere është lidhur edhe kontrata e hipotekimit me nr. {***} rep., nr. {***} kol., sipas së cilës është vendosur në favor të kreditorit përfutues, BKT-së, hipotekimi i pasurisë së paluajtshme në pronësi të subjektit të rivlerësimit, si mjet për garantimin e shlyerjes së kredisë.

29. Në datën 24.12.2007, në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit pranë BKT-së, me nr. {***}, është depozituar *cash* vlera prej 3.300.000 lekësh nga z. Rr. P., me përshkrimin “Derdhje në llogari për garanci shlyerje kredie”. Po në këtë datë, z. Rr. P. ka nënshkruar një deklaratë noteriale para noterit publik A. K. me nr. rep {***}, në të cilën ka deklaruar se ka arkëtuar në llogarinë me nr. {***}, të hapur pranë BKT-së dega Shkodër, në emër të z. Astrit Kalaja, shumën 3.300.000 lekë, për të shërbyer si garanci për kredinë që z. Astrit Kalaja ka marrë pranë BKT-së me qëllim që të lirohet hipoteka e vënë nga z. Astrit Kalaja në favor të bankës, mbi apartamentin me sip. 63 m². Kjo shumë deklarohet se do të rrijë në favor të BKT-së, dega Shkodër, deri në shlyerjen e kredisë që z. Astrit Kalaja ka marrë pranë kësaj banke [...].

30. Në datën 26.12.2007, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e palës shitëse, dhe z. A. H. V., në cilësinë e palës blerëse, kanë lidhur përpara noterit A. K. një kontratë noteriale me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., për shitblerje me kusht të pasurisë së paluajtshme “apartament banimi”, me sip. 63 m² dhe adresë në {***}. “{***}”, rruga “{***}”, Shkodër. Në nenin 2.2 të kësaj kontrate, është përcaktuar: *Me deklaratën noteriale nr. {***}, datë 24 dhjetor 2007, noter A. S. K., Shkodër dhe me mandatarkëtimin nr. {***}, datë 24 dhjetor 2007, të BKT-së dega Shkodër, janë arkëtuar 3.300.000 lekë të reja, si garanci për shlyerje kredie. Ndërsa në nenet 4.2 dhe 4.3 të po kësaj kontratë, thuhet: Kjo shitje bëhet me kusht hipotekimi, pra prona do të vazhdojë të qëndrojë e hipotekuar në favor të BKT-së, dega Shkodër, deri në shlyerjen e plotë të detyrimeve ndaj bankës, ose do të zëvendësohet me pronë tjetër, po sipas miratimit të BKT-së. Shitësi merr përsipër që në marrëveshje me BKT-në, të bëjë zëvendësimin e hipotekës, që sipas marrëveshjes do të bëhet deri më 31 mars 2008 dhe t'i kalojë të gjitha tagrat e pronësisë.*

31. Më datë 27.12.2007, në prani të noterit A. K., është lidhur dhe nënshkruar nga: (i) subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kredimarrësit/barrëdhënësit; (ii) bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e dorëzanesës; dhe (iii) nga përfaqësuesit e BKT-së, në cilësinë e kredidhënësit, kontrata e kredisë bankare (e siguruar me depozitë bankare)¹¹ me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., në të cilën është parashikuar se pjesa e mbetur e kredisë për t'u paguar nga kredimarrësi do të sigurohet me anë të llogarisë bankare në emër të z. Astrit Kalaja me nr. {***}, në degën BKT Shkodër dhe do garantohet me shumën 3.300.000 lekë. Sipas kësaj kontrate, në nenin 8 të saj është përcaktuar shprehimisht:

8.1 *Kredimarrësi/barrëdhënës, z. Astrit Kalaja, është titullar i llogarisë bankare nr. {***} në degën e BKT-së Shkodër dhe ka rënë dakord të garantojë me shumën 3.300.000 (tre milionë e treqind mijë) lekë kredisë e marrë në BKT.*

8.2 *Kredimarrësi/barrëdhënës, si titullar i llogarisë së mësipërme, i kalon titullin bankës mbi llogarinë bankare dhe interesat që rrjedhin nga ajo, për të garantuar përmbushjen e plotë të detyrimit. Për sa kohë që kredia është e papërmbushur, banka do të jetë titullare e llogarisë bankare. [...]*

8.4 *Dorëzanesi autorizon bankën që të prekë pa asnjë paralajmërim dhe formalitet llogarinë bankare kur kredimarrësi është në vonesë të shlyerjes së një apo më shumë detyrimeve të rrjedhura nga kontrata e kredisë. Për këtë qëllim, dorëzanesi autorizon në mënyrë të parevokueshme bankën të debitojë llogarinë bankare në çdo kohë dhe për çdo shumë të lindur për shkak të kontratës së kredisë.*

Në po të njëjtën datë, subjekti i rivlerësimit vihet re të ketë bërë kalimin e shumës së depozituar nga z. Rr. P., prej 3.300.000 lekësh, nga llogaria e tij rrjedhëse e kredisë në llogarinë e garancisë së kredisë, sipas parashikimeve të kontratës së sipërcituar.

32. Në datën 13.02.2008, znj. V. P dhe z. S. P, në cilësinë e përfaqësuesve të BKT-së, kanë nënshkruar para noterit publik I. L. një deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., me anë të së cilës kanë deklaruar se përfituesi BKT heq dorë nga hipoteka e pasurisë “apartament” me sip. 63 m² [...] meqenëse kjo pasuri për sigurimin e kredisë së marrë pranë BKT-së nga Astrit Kalaja, është zëvendësuar me një kolateral tjetër. Në vazhdim, rezulton se është hequr barra hipotekore ndaj pasurisë së sipërcituar dhe blerësi, z. V., ka kryer pagesën e pjesës së mbetur të çmimit të apartamentit prej 3.500.000 lekësh, nëpërmjet depozitimeve në llogarinë e subjektit të rivlerësimit pranë Bankës Raiffeisen në datën 04.03.2008, të vlerave 2.700.000 lekë dhe 600.000 lekë.

33. Nga llogaria e garancisë së kredisë, rezulton të jetë kryer një transaksion tërheqjeje në *cash*, në datën 08.06.2010, në vlerën e 2.000.000 lekëve, me urdhërues subjektin e rivlerësimit Astrit Kalaja dhe përfitues z. Rr. P.¹². Gjithashtu, në datën 23.02.2012, është kryer një tjetër transaksion tërheqjeje në *cash*, në vlerën e 1.300.000 lekëve, me urdhërues dhe përfitues sipas mandatit përkatës bankar¹³, subjektin e rivlerësimit Astrit Kalaja.

34. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara si më sipër, trupi gjykues vlerësoi se:

i. *Në lidhje me marrëdhënien e krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe z. Rr. P.*

¹¹ Kjo rezulton të jetë kontrata e rishikuar e kredisë së lëvruar sipas Kontratës së Kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.02.2007, para noterit A. A., si pasojë e zëvendësimit të kolateralit me të cilin ishte siguruar kredia, nga hipotekimi i pasurisë së paluajtshme me sip. 63 m² në garanci me depozitë bankare.

¹² Referoju mandatit bankar, faqe 306 e fashikullit nr. 3 të çështjes.

¹³ Referoju mandatit bankar, faqe 308 e fashikullit nr. 3 të çështjes.

35. Referuar marrëdhënies juridike të kredisë mes subjektit të rivlerësimit dhe BKT-së, të materializuar në kontratën e rishikuar të kredisë, “Kontrata e kredisë bankare (e siguruar me depozitë bankare)”¹⁴, trupi gjykues vëren se z. Rr. P. nuk paraqitet në cilësinë e personit që ka vënë barrë siguroese në favor të bankës me qëllim sigurimin e kredisë së marrë nga subjekti i rivlerësimit. Këtë cilësi, sipas parashikimeve të kontratës së sipërcituar, e ka subjekti i rivlerësimit, i cili mbi llogarinë e tij të garancisë së kredisë, në të cilën ka depozituar shumën prej 3.300.0000 lekësh, ka vendosur barrë siguroese në favor të bankës, në shumën e kësaj depozite, për garantimin e të gjitha detyrimeve që i kanë lindur, si pasojë e kredisë së lëvruar nga kjo bankë, më datë 14.02.2007. Gjithashtu, në cilësinë e dorëzanësit të kësaj kredie, paraqitet bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, e cila mban përgjegjësi me gjithë pasurinë e saj për përmbushjen e detyrimeve që ka ndërmarrë subjekti i rivlerësimit me marrjen e kredisë dhe jo z. Rr. P..
36. Trupi gjykues vlerësoi se z. Rr. P., me depozitim të shumës prej 3.300.000 lekësh në gjendje *cash*, në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit, me qëllim garantimin e kredisë së marrë prej tij, nuk mund të fitojë cilësinë juridike të garantorit të kësaj kredie, për sa kohë z. Rr. P. nuk ka hyrë në marrëdhënie të drejtpërdrejtë me bankën, me qëllim sigurimin e kredisë së subjektit të rivlerësimit.
37. Në interpretim të neneve 1024 e vijues të Kodit Civil mbi kontratat bankare, si dhe referuar parashikimeve të “Kontratës së kredisë bankare (e siguruar me depozitë bankare)” me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 27.12.2007, më konkretisht nenit 8 të saj, si më sipër cituar¹⁵, z. P., me depozitim në bankë të shumës prej 3.300.000 lekësh në *cash*, në llogarinë rrjedhëse bankare me nr. {***} në degën e BKT-së Shkodër, në emër të subjektit të rivlerësimit, ka kaluar pronësinë e këtyre parave te z. Kalaja deri në shlyerjen e plotë të kredisë së marrë nga banka. Subjekti i rivlerësimit i ka disponuar lirisht këto para duke i tërhequr ato nga llogaria rrjedhëse e kredisë dhe duke i vendosur si depozitë bankare në llogarinë e garancisë së kredisë, me qëllim sigurimin e kredisë së marrë pranë së njëjtës bankë dhe, për rrjedhojë, duke e bërë bankën titullare të kësaj llogarie bankare dhe të interesave që rrjedhin prej saj, deri në përmbushjen e plotë të detyrimit të lindur nga kredia e lëvruar në datën 14.02.2007. Subjekti i rivlerësimit është sjellë si pronar i këtyre parave, përkundëjt bankës dhe z. Rr. P., edhe në momentin kur ka kryer transaksionet e tërheqjes së shumave në *cash*, në vlerat 2.000.000 lekë dhe 1.300.000 lekë, përkatësisht në datat 08.06.2010 dhe 23.02.2012, si më sipër cituar.
38. Pretendimet e ngritura para Kolegjit nga subjekti i rivlerësimit dhe avokati i tij, se në rastin objekt gjykimi kemi të bëjmë me një marrëdhënie juridike pengu dhe jo huadhënieje, trupi gjykues i gjeti të pabazuara në fakte dhe në ligj. Në arritjen e këtij përfundimi, trupi gjykues mbajti në konsideratë bazën ligjore¹⁶ që ka rregulluar marrëdhënien e krijuar mes palëve nënshkruese të kontratës së kredisë së siguruar me depozitë bankare¹⁷ dhe e vlerësoi atë në kuadër të parashikimeve të nenit 546, “Pengu”, të Kodit Civil, sipas të cilit dispozitatat për pengun nuk zbatohen ndaj kredive që lidhen me transaksione financiare, ndaj të cilave janë vendosur barrë siguroese, sipas kritereve të përcaktuara me ligj të veçantë.

¹⁴ Kontrata me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 27.12.2007, në prani të noterit A. K..

¹⁵ Shih paragrafin 31 më sipër në këtë vendim.

¹⁶ Ndër të tjera nenin 585 të Kodit Civil, “Dorëzania”; nenin 1031 të Kodit Civil, “Hapja e kredisë bankare” e në vazhdim, si dhe dispozitatat e ligjit nr. 8537, datë 18.10.1999, “Për barrët siguroese”, i ndryshuar.

¹⁷ Kontrata me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.12.2007.

39. Për rrjedhojë të sa më sipër dhe në interpretim të dispozitave përkatëse të Kodit Civil mbi kontratën e huas¹⁸, trupi gjykues arriti në konkluzionin se marrëdhënia e krijuar mes z. Rr. P. dhe subjektit të rivlerësimit, si pasojë e depozitimit nga z. P. në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit të shumës prej 3.300.000 lekësh, përmbush kërkesat e nenit 1050 të Kodit Civil, për ta vlerësuar këtë marrëdhënie në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar si një marrëdhënie huaje, me objekt shumën prej 3.300.000 lekësh e cila, referuar deklaratës noteriale të datës 24.12.2007, të z. Rr. P., i është dhënë subjektit të rivlerësimit me qëllim garantimin e kredisë së marrë nga BKT-ja dhe me afat deri në shlyerjen e saj.

ii. *Në lidhje me efektin e kësaj marrëdhënieje huaje dhe mosdeklarimin e saj ndër vite, në kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit*

40. Nga analizimi i transaksioneve të kryera në llogarinë e garancisë së subjektit të rivlerësimit si më sipër përmendur¹⁹, trupi gjykues vëren se nga totali i vlerës së dhënë hua nga z. Rr. P. subjektit të rivlerësimit, ky i fundit më datë 08.06.2010 ka tërhequr pranë bankës vlerën prej 2.000.000 lekësh, me qëllim kthimin e tyre z. P., i cili paraqitet edhe në mandatin bankar si përfituesi i kësaj tërheqjeje bankare. Trupi gjykues vëren gjithashtu se kjo shumë, e cila rezulton të jetë pjesë e shumës së dhënë hua nga z. P., ka shërbyer vetëm për qëllimin e garantimit të kredisë, pasi nuk rezulton të jetë futur në qarkullim nga ana e subjektit të rivlerësimit për t'u përdorur as për krijim pasurie, as për mbulim shpenzimesh të tjera të ekonomisë së tij familjare dhe as rezulton të jetë deklaruar si burim për qëllime të kësaj natyre. Në kushtet kur kthimi i kësaj pjese të huas huadhënësit, z. Rr. P., rezulton të jetë kryer nga subjekti i rivlerësimit nga paratë e bllokuara në depozitën e garancisë, trupi gjykues arrin në përfundimin se kjo pjesë e huas nuk ka sjellë asnjë pasojë në analizën e kryer në kuadër të kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit (përveç sigurimit të kredisë).

41. Ndërkohë pjesa e mbetur e huas së dhënë, shuma prej 1.300.000 lekësh të cilën subjekti i rivlerësimit e ka tërhequr më datë 23.02.2012, rreth 6 muaj pas shlyerjes së plotë të kredisë, rezulton të mos i jetë kthyer huadhënësit, z. P., në momentin e tërheqjes së saj nga banka. Referuar përmbajtjes së deklaratës noteriale²⁰ të z. Rr. P. me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.10.2014, para noterit A. K., si dhe pranimit të heshtur të këtij deklarimi nga subjekti i rivlerësimit në shpjegimet²¹ e dhëna ndaj rezultateve të hetimit administrativ, kjo shumë parash nuk i është dorëzuar z. P. në momentin e tërheqjes nga banka, pasi deklarohet t'i jetë shlyer paraprakisht nga subjekti i rivlerësimit në periudhën kohore shtator 2008 - shkurt 2013. Për rrjedhojë të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se kjo shumë parash e cila i është kthyer z. P. gjatë intervalit të sipërcituar kohor, është mbuluar nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, duke

¹⁸ Neni 1050 i Kodit Civil parashikon: "Me kontratën e huas njëra palë (huadhënësi) i jep në pronësi palës tjetër (huamarrësit) një shumë të hollash ose sende që përcaktohen në numër, me peshë ose me masë dhe huamarrësi detyrohet t'i kthejë huadhënësit aq të holla, ose aq sende të atij lloji dhe të asaj cilësie, brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e huadhënësit".

¹⁹ Shih paragrafin 33 më sipër në këtë vendim.

²⁰ Në këtë deklaratë, lidhur me shumën prej 1.300.000 lekësh, z. P. ka deklaruar: "Nga koha e sigurimit të kredisë, duke filluar nga shtatori i vitit 2008 e deri në kohën që ka përfunduar shlyerja e kredisë, në muajin shkurt 2013, nga Astrit Kalaja kohë pas kohe kam marrë shuma parash që varionin nga 50.000 deri në 150.000 lekë të reja. [...] Me mbylljen e kredisë, lekët që kishin mbetur në llogarinë e garancisë, rreth 1.300.000 lekë, ia kam kthyer z. Astrit Kalaja, meqenëse gjatë viteve që kjo shumë ka qenë e bllokuar, unë këto lekë ia kisha marrë".

²¹ Në faqen 9 të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit ndaj rezultateve të hetimit, ky i fundit, tek shpjegon arsyen se pse nuk ka deklaruar shlyerjen e shumave ndaj z. P., shprehet: "Për sa i përket konstatimit se nuk janë deklaruar pagesat e subjektit për shlyerjet (kthimin pas) e këtyre shumave ndaj z. P., të pretenduara si të kryera në vitet 2008-2013, shpjegoj se këto shuma nuk janë vlerësuar nga ana ime si kthim pas i lekëve që kanë shërbyer për garantimin e kolateralit. Ato janë konsideruar nga unë si konsum jetese [...]".

sjellë kështu pasoja të drejtpërdrejta në ekonominë e tij familjare për periudhën kohore si më sipër cituar sipas rezultatit të analizës financiare, pavarësisht se shuma e marrë hua (vlera prej 1.300.000 lekësh) nuk është përdorur, madje as nuk është deklaruar si burim për krijim të ndonjë pasurie të subjektit të rivlerësimit.

42. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se vetëm kjo pjesë e huas, në vlerë prej 1.300.000 lekësh, ka sjellë një efekt të matshëm në analizën financiare të kryer gjatë kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit duke ngarkuar periudhën e viteve 2008-2013 me një detyrim monetar në formën e shpenzimit për kthim huaje, ndonëse huaja është përdorur për qëllimin e vetëm të garantimit të shlyerjes së kredisë ndaj BKT-së. Për rrjedhojë, vetëm kjo pjesë e huas mund të prodhojë pasojat juridike në drejtim të zbatimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
43. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues arrin në konkluzionin se me të drejtë Komisioneri Publik pretendoi se Komisioni ka gabuar në moskonsiderimin e marrëdhënies së krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe z. P. si marrëdhënie huaje, por gjithashtu ndryshe nga sa pretendoi Komisioneri Publik, trupi gjykues vlerësoi se vetëm një pjesë e huas së marrë mund të merrej në shqyrtim në kuptim të parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të analizës lidhur me kontrollin e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të. Por për arsyet e treguara më sipër, në kushtet kur edhe kjo pjesë e huas nuk ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë objekt kontrolli dhe as të ndonjë pasurie tjetër të krijuar në vijim nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nuk prodhoi pasoja negative në analizën financiare, trupi gjykues e çmoi të panevojshme kryerjen e një analize për verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të z. Rr. P. për shumën e dhënë hua²².
44. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se deklarimet e subjektit të rivlerësimit dhe të shtetasve Rr. P. dhe V. F. lidhur me burimin e shumës prej 3.300.000 lekësh krijojnë paqartësi në drejtim të identifikimit të huadhënësit real, trupi gjykues vlerësoi se, referuar fakteve të provuara nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit në Komision, huadhënësi i shumës prej 3.300.000 lekësh rezultoi të jetë z. Rr. P.. Në mungesë të fakteve që provojnë se z. P. ka vepruar në emër dhe për llogari të një personi të tretë, ai vlerësohet nga trupi gjykues si huadhënësi i shumës prej 3.300.000 lekësh, provuar me mandatin bankar të depozitimit të kësaj shume pranë BKT-së, si dhe me deklaratën noteriale të përpiluar në datën e depozitimit të shumës. Për rrjedhojë, ky pretendim i Komisionerit Publik, përveçse nuk gjendet i bazuar në fakte, në vijim të analizës së mësipërme nuk sjell efekte në kontrollin e vendimit të Komisionit lidhur me këtë pasuri.
45. Sa i takon mosdeklarimit nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike pranë ILDKPKI-së, të marrëdhënies së huas dhe shlyerjes së saj, trupi gjykues, në vijim edhe të sa konstatuar më sipër në vendim, e gjen të drejtë dhe të bazuar në ligj pretendimin e Komisionerit Publik se kjo marrëdhënie interesi e krijuar mes palëve duhet të ishte deklaruar rregullisht që nga momenti i krijimit dhe deri në shuarjen e saj, në deklarimet periodike të subjektit pranë ILDKPKI-së. Megjithatë trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë se në deklaratën e pasurisë *vetting* kjo marrëdhënie huaje është deklaruar rregullisht prej subjektit të rivlerësimit, vlerëson se duhet të analizohet vetëm në kuptim të efekteve juridike në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vlerësoi gjithashtu se subjekti i rivlerësimit nëpërmjet deklarimit në deklaratën e pasurisë *vetting* të marrëdhënies së huas së krijuar mes tij dhe z. P., duke marrë parasysh pasojat juridike të

²² Në të njëjtin konkluzion ka arritur Kolegji edhe në një çështje të ngjashme ku huaja e marrë nga subjekti i rivlerësimit në atë rast ishte përdorur vetëm si garanci financiare në procedurën për marrjen e një vize kalimi nga një ambasadë e huaj, pa sjellë asnjë efekt në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, duke qenë se huaja nuk ishte përdorur prej tij si burim për krijim pasurie. Shih vendimin e Kolegjit nr. 24/2021 (JR), paragraf. 20, faqe 22-23.

zbatimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si dhe riskun e një vlerësimi negativ si pasojë e evidentimit dhe pranimit të problematikave në deklaratimet e tij periodike vjetore, ka treguar qëndrim bashkëpunues në mbështetje të procesit të rivlerësimit, duke u dhënë mundësinë institucioneve rivlerësuese për të kryer një kontroll të plotë për një vlerësim të drejtë dhe objektiv lidhur me kontrollin e pasurisë objekt shqyrtimi. Për më tepër, trupi gjykues çmon se mosdeklarimi i këtij fakti juridik nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike, nuk pamundësoi institucionet e rivlerësimit për kontrollin dhe verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve të tij lidhur me pasurinë e deklaruar dhe mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e saj, për sa kohë u provua nga analiza e mësipërme që fakti i padeklaruar (huaja e marrë nga z. Rr. P.) nuk kishte shërbyer as si burim për krijimin e pasurisë objekt kontrolli dhe as ndërthurej me transaksione të tjera të mëvonshme të kryera lidhur me këtë pasuri. Për rrjedhojë, trupi gjykues, pasi çmoi të ritheksojë vlerën që kanë deklaratimet e mëparshme të subjekteve të rivlerësimit në kuadër të kontrollit dhe vlerësimit, jo vetëm të vërtetësisë dhe saktësisë së deklaratës së pasurisë *vetting*, por edhe të ligjshmërisë së krijimit të pasurive të subjekteve, qëndrim ky i konsoliduar në jurisprudencën e Kolegjit, arrin në konkluzionin se për shkak të specifikave të analizuara më sipër, pasaktësia e deklaratimeve periodike në rastin konkret nuk çmohet se përbën shkak për deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë objekt kontrolli, dhe se qëndrimi i Komisionit në drejtim të sa më sipër nuk bie ndesh me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit sa i takon rëndësisë së deklaratimeve ndër vite.

iii. *Në lidhje me trajtimin e të ardhurave të krijuara nga shitja e apartamentit me sip. 63 m² në Shkodër, në vitin 2007, në vlerën e 3.500.000 lekëve*

46. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se burimi i deklaruar “të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 63 m²”, të përdorura për pagesën e këstit të dytë të çmimit të apartamentit me sip. 109,5 m², nuk justifikohet me të ardhura të ligjshme, si pasojë e deklarimit jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, të kursimeve në gjendje *cash* nga ana e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi si më poshtë.
47. Me anë të kontratës “Shitblerje me kusht pasurie të paluajtshme (apartament banimi)” të datës 26.12.2007, të lidhur mes subjektit të rivlerësimit në cilësinë e shitësit dhe z. A. V. në cilësinë e blerësit, subjekti ka shitur apartamentin e tij me sip. 63 m², me çmim shitjeje 3.500.000 lekë dhe, pas regjistrimit në ZVRPP Shkodër të deklaratës noteriale të kredidhënësit (BKT) me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.02.2008, për heqjen dorë nga hipoteka e vendosur në favor të BKT-së për sigurimin e kredisë së marrë nga subjekti i rivlerësimit, blerësi, z. V., ka kryer pagesën e pjesës së mbetur të çmimit të apartamentit prej 3.500.000 lekësh, nëpërmjet depozitimeve në llogarinë e subjektit të rivlerësimit pranë Bankës Raiffeisen, të vlerave 2.700.000 lekë dhe 600.000 në datën 04.03.2008.
48. Në kontratën e sipërmarrjes së datës 28.02.2008, për porositjen e apartamentit me sipërfaqe 109,5 m², si specifikuar më sipër në vendim²³, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *kësti i dytë përcaktohet në kontratë për t’u paguar deri në gjashtë muaj pas regjistrimit të apartamentit në ZVRPP Shkodër, ose me shitjen e apartamentit tjetër pronë e porositësit, e hipotekuar (bllokuar) në favor të Bankës Tregtare Kombëtare.*
49. Ndërkohë, në deklaratën periodike të vitit 2008, në rubrikën “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Të ardhura nga shitja e apartamentit të vjetër me kontratë*

²³ Referojuni paragrafit nr. 26 të këtij vendimi.

me nr. rep. {***}, dt. 26.12.2007 (regjistruar në regjistrin në ZRPP Shkodër ZK {***} nr. pasurisë {***}) derdhur në llogarinë e pagës në Raiffeisen Bank më dt. 04.03.2008 (diferenca nga çmimi me lekë cash të dhëna në formë paradhënie) - vlera: 3.500.000 lekë. Ndërsa në deklaratën periodike pasardhëse të vitit 2009, në rubrikën “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pakësim vlere në lekë. Kam shlyer diferencën e çmimit të shtëpisë së re (13.400 euro) me/nga lekët e shtëpisë që kam shitur e deklaruar në deklaratën e mëparshme. Nga shuma 3.500.000 lekë (vlera e shtëpisë së vjetër) – vlera: 13.400 (trembëdhjetë mijë e katërqind) euro ose rreth 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë.* Gjithashtu, rezultoi se në rubrikën e detyrimeve financiare ndaj të tretëve, subjekti ka deklaruar se ka shlyer detyrimin ndaj shoqërisë “{***}” ShPK.

50. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarisë së subjektit në Bankën Raiffeisen, konstatohet se në datat 21.04.2008 dhe 06.05.2008 janë tërhequr nga subjekti i rivlerësimit, respektivisht shumat prej 1.000.000 lekësh dhe 2.500.000 lekësh, të cilat i përkasin vlerës së realizuar nga shitja e apartamentit, e depozituar nga blerësi në llogarinë e subjektit të rivlerësimit.
51. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vuri re se në deklaratën periodike të vitit 2008, e ardhura e realizuar nga shitja e apartamentit me sip. 63 m², ndonëse e deklaruar saktësisht në drejtim të vlerës së saj, ishte deklaruar në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë dhe interesave privatë dhe jo në rubrikën e të ardhurave. Ndërkohë ndryshimi i gjendjes së pasurisë likuiditet nga “likuiditet në llogari bankare” në “likuiditet në gjendje cash jashtë sistemit bankar”, pas tërheqjeve të realizuara respektivisht në datat 21.04.2008 dhe 06.05.2008, nuk rezultoi i pasqyruar në asnjë prej rubrikave të deklaratës periodike të vitit 2008.
52. Sa i takon deklarimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* se kësti i dytë i çmimit të apartamentit me sip. 109,5 m², në vlerën e 1.675.650 lekëve, kishte si burim të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit me sip. 63 m², trupi gjykues konstatoi se ky nuk ishte një deklaram rastësor i subjektit të rivlerësimit, që i atribuohet nevojave për të justifikuar burimin e krijimit të pasurisë në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Kjo pasi, jo vetëm që ky burim ishte deklaruar nga subjekti i rivlerësimit që në deklaratën përkatëse periodike të vitit 2009, kur edhe u krye pagesa, por për hir të fakteve, referuar historikut të ngjarjeve lidhur me krijimin e kësaj pasurie, të konstatuara më sipër nga trupi gjykues, përfaqësonte vetë qëllimin e subjektit të rivlerësimit, në drejtim të mënyrës së shlyerjes së çmimit të apartamentit me sip. 109,5 m², që në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për porositjen e tij²⁴.
53. Për rrjedhojë, në konsideratë të fakteve dhe rrethanave specifike si më sipër trajtuar, trupi gjykues, edhe pse vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2008, në formën e duhur dhe në mënyrë të shprehur, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, shtimin e pasurisë likuiditet në gjendje *cash* në banesë, si pasojë e tërheqjeve bankare të të ardhurave të krijuara nga shitja e pasurisë, e çmoi të përmbushur deklarimin e posedimit të një gjendjeje likuiditeti *cash* në masën e këtyre tërheqjeve, sa kohë në datën e dorëzimit të deklaratës periodike të vitit 2008, këto të ardhura me burim shitjen e apartamentit me sip. 63 m², ishin deklaruar në rubrikën e shtesave dhe pakësimeve të pasurive, si një pasuri në formë likuiditeti. Ky përfundim i trupit gjykues përforcohet edhe nga deklarimet në vijim të përdorimit të këtij likuiditeti nga ana e subjektit të rivlerësimit, të cilat shprehen nga subjekti me nocionin e pakësimit të pasurisë dhe deklarohen pikërisht në rubrikën e shtesave dhe pakësimeve të interesave privatë të

²⁴ Kontrata e sipërmarrjes rezultoi të ishte nënshkruar vetëm 2 muaj pas nënshkrimit të kontratës së shitjes me kusht të apartamentit me sip. 63 m².

deklaratave periodike²⁵, pavarësisht se pagesat e kryera me këtë likuiditet ndaj palëve të treta janë deklaruar rregullisht në formën e kërkuar nga ligji edhe në rubrikën e detyrimeve financiare të deklaratave periodike. Gjithashtu, edhe referimi në deklarin e bërë në deklaratën periodike të vitit 2010: *kam shlyer një pjesë të kredisë nga kursimet në cash në shtëpi, të përbëra (kursime në cash dhe lekë nga shitja e shtëpisë së deklaruar në deklarin e mëparshme)*, u çmua si një element që çoi në krijimin e bindjes së trupit gjykues lidhur me vërtetësinë e deklarimeve të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, në drejtim të konceptimit të tij të mënyrës së deklarin të kursimit në gjendje *cash*.

54. Në analizë të pretendimit të Komisionerit Publik se konkluzionet e tij mbi bazën e të cilave ka ngritur këtë shkak ankimi për pamjaftueshmëri të subjektit të rivlerësimit në pagesën e kështit të dytë të çmimit të apartamentit, mbështeten edhe në qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, për interpretimin dhe zbatimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në veçanti lidhur me kuptimin e pasurisë së ligjshme, e ndërlidhur me momentin e deklarin në deklaratat periodike të likuiditeteve, trupi gjykues, pasi vlerësoi faktet dhe rrethanat specifike të çështjes objekt gjykimi në krahasim me situatën faktike të vendimmarrjeve të përmendura nga Komisioneri Publik në ankimin e tij, konstatoi se konkluzionet e arritura në këto vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit nuk mund të shërbejnë si bazë për kundërshtimin e vendimit të Komisionit në drejtim të vlerësimit të likuiditeteve gjendje *cash*, të përdorura si burim për krijimin e pasurisë objekt kontrolli në çështjen për gjykim, për sa kohë situatat faktike që kanë diktuar konkluzionet e referuara, nuk përputhen.
55. Sa i takon pretendimit të Komisionerit Publik se shpenzimi mjekësor i kryer në vitin 2008, përveçse i padeklaruar në deklaratën periodike të vitit 2008, në shkelje të detyrimeve që burojnë nga parashikimet e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, përbënte tregues të shpenzimeve të kryera gjatë atij viti duke mos përjashtuar mundësinë e ekzistencës së shpenzimeve të tjera të padeklaruara, ai u gjet i pambështetur nga trupi gjykues. Në kuadër të arritjes së këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë faktin që ky shpenzim mjekësor i kryer nga ana e subjektit të rivlerësimit në vitin 2008, referuar legjislacionit të kohës, nuk përbënte një detyrim ligjor sa kohë “shpenzimi i deklarueshëm”, si nocion i tërësisë monetare të shpenzuar përtej një vlere të caktuar, u përcaktua si detyrim për deklarin nga subjektet deklaruese, me miratimin e ligjit nr. 85/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar²⁶.
56. Për rrjedhojë, deklarin nga ana e subjektit të rivlerësimit e këtij shpenzimi mjekësor, përveçse nuk ka përbërë një detyrim ligjor në kohën kur ka ndodhur, nuk ka përbërë gjithashtu as një detyrim në kuadër të procesit të rivlerësimit në drejtim të deklarin të fakteve të ndryshme të kërkuara nga Komisioni, nëpërmjet pyetësorëve, me qëllim mbledhjen e të dhënave relevante për procesin, duke

²⁵ Në deklaratën periodike të vitit 2009, në rubrikën e ndryshimit të interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Pakësim në vlerë në lekë. Kam shlyer diferencën e çmimit të shtëpisë së re (13.400 euro) me lekët e shtëpisë që kam shitur e deklaruar në deklaratën e mëparshme. Nga shuma 3.500.000 lekë (vlere e shtëpisë së vjetër)”.

Në deklaratën periodike të vitit 2010, në rubrikën e ndryshimit të interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Pakësim në vlerë në lekë, kam shlyer një pjesë të kredisë nga kursimet në cash në shtëpi, të përbëra (kursime në cash dhe lekë nga shitja e shtëpisë së deklaruar në deklarin e mëparshme)”.

²⁶ Shih nenet 1 dhe 3 të ligjit nr. 85/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.

qenë se fakti i deklaruar kishte ndodhur përtej periudhës së shtatë viteve të fundit²⁷. Ky deklaram i subjektit në përgjigjet e dhëna lidhur me pyetësorin nr. 2 të Komisionit, më datë 26.04.2019, në kuadër të evidentimit të gjendjes së kursimeve *cash* në fund të çdo viti deklarimi, i kryer me vullnetin e lirë të subjektit të rivlerësimit dhe në kushtet e mungesës së detyrimit për deklaram, nuk mund të përbëjë premisë për krijimin te trupi gjykues të dyshimit të arsyeshëm në drejtim të mungesës së sinqeritetit të subjektit të rivlerësimit. Në kuptim të sa më sipër, një analizë mbi bazë prezumimi për ekzistencë të shpenzimeve të tjera të padeklaruara, çmohet nga trupi gjykues se rëndon në mënyrë të padrejtë pozitën e subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, nuk mund të shërbejë si shkak për vlerësimin se të ardhurat e ligjshme në përdorim të subjektit në vitin 2008, janë shpenzuar në tërësinë e tyre, edhe pse gjatë procesit të hetimit në Komision nuk u faktua ekzistenca e shpenzimeve të tjera, përveçse sa përcaktuar në analizën financiare të Komisionit.

57. Në përfundim të analizës së kryer më sipër, trupi gjykues, pasi krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën periodike të vitit 2008, ka deklaruar në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë, posedimin e një likuiditeti në vlerën prej 3.500.000 lekësh, me burim të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit të banimit me sipërfaqe 63 m², arriti në përfundimin se një pjesë e këtij likuiditeti, deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2009, si burim për pagesën e kështit të dytë të çmimit të apartamentit me sip. 109,5 m², përbën një burim të ligjshëm në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016.
58. Trupi gjykues çmoi se të njëjtat argumente si në analizën e kryer në paragrafët e mësipërm vlejné edhe në drejtim të shqyrtimit të pretendimit tjetër të Komisionerit Publik për moskonsiderimin me burime të ligjshme të pagesës për shlyerjen e pjesëshme të kredisë më datë 26.03.2010, në vlerën prej 2.000.000 lekësh, si pasojë e problematikave të adresuara më sipër në deklaramin e kursimit gjendje *cash* me të njëjtin burim “të ardhurat nga shitja e pasurisë apartament me sip. 63m². Për rrjedhojë, për sa kohë bëhet fjalë për të njëjtin burim të ardhurash, për të cilin trupi gjykues pas analizës së kryer e vlerësoi si burim të ligjshëm, pretendimi i Komisionerit Publik në drejtim të sa më sipër gjendet i pabazuar në fakte.
59. Në përfundim të analizës lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 109,5 m², me vendndodhje në lagjen “{***}”, Shkodër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se ky shkak gjendet i pabazuar në fakte dhe në ligj. Për rrjedhojë, vlerësimi i Komisionit lidhur me kontrollin e kësaj pasurie të subjektit të rivlerësimit, vlerësohet i drejtë dhe i bazuar.
60. *Lidhur me shkakun e ankimit për deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së paluajtshme të llojit “tokë arë” me sip. 379 m², me vendndodhje {***}-Plazh, Shkodër, trupi gjykues konstatoi sa më poshtë.*
61. Në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me pasurinë e sipërcituar, Komisioni ka vendosur se i konsideron të besueshme dhe bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie dhe, ndër të tjera, ka arsyetuar në vendimin e tij: *Nisur nga situata faktike e përshkruar më sipër dhe duke e analizuar atë me të njëjtin këndvështrim që ndërthur analizën e fakteve dhe rrethanave me arsyetimin logjiko-ligjor, të përdorur në rrethanat analoge që lidheshin me burimet e pasurisë nr. 1 – në paragrafët 1.33 - 1.36, të këtij vendimi – me qëllim arrijten e një vlerësimi sa më objektiv të rastit në fjalë, si dhe duke konsideruar shpjegimet e subjektit lidhur me*

²⁷ Shih pyetësorin e parë standard të përdorur nga Komisioni, më konkretisht pyetjen nr. 8, e cila kërkon informacion për trajtime mjekësore që tejkalojnë vlerën e 1000 eurove, të kryera në shtatë vitet e fundit.

burimet e krijimit të kësaj pasurie, Komisioni i konsideron këto të fundit si të besueshme dhe bindëse, për shkaqet që vijnë. [...] Nisur nga situata faktike e sipërpërshkruar, mosdeklarimi si gjendje cash në banesë, në fund të vitit 2012, i shumës prej 2.000.000 lekësh, tërhequr nga banka, po në vitin 2012, mund të shpjegohet në dy mënyra: (i) ose subjekti i rivlerësimit e ka shpenzuar të gjithë këtë shumë përpara datës 31.12.2012; (ii) ose sipas interpretimit të vet, nuk e ka konsideruar të nevojshëm/detyrueshëm deklarin e kësaj shume (ose pjesës së saj) të disponuar de facto si cash në atë datë. Nga një analizë logjike dhe vlerësim i përbashkët i rrethanave që lidhen me këtë fakt dhe i shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se, ndonëse teorikisht është i mundshëm, varianti i parë – i shpenzimit të të gjithë shumës prej 2.000.000 lekësh përpara datës 31.12.2012 – rezulton më pak bindës se i dyti. Kjo për dy fakte të provuara: nga njëra anë, subjekti nuk ka paraqitur një stil jetese në nivel kaq të lartë të shpenzimeve jetike vjetore, për të justifikuar këtë shpenzim vetëm brenda disa muajve (të vitit 2012) dhe nuk ka asnjë të dhënë që të çojë në hipotizimin e shpenzimit të kësaj shume për ndonjë tjetër arsye (blerje/investim/udhëtim/kurim). [...] Lidhur me peshën specifike dhe pasojat e mundshme të pasaktësisë së deklarin të gjendjes cash në fund të vitit 2012 – për sa kohë është bërë për një shumë më të vogël nga sa mendohet se subjekti ka disponuar – Komisioni e çmon si të pamjaftueshme për të aplikuar masën e parashikuar nga pika 3 e nenit 61 e ligjit nr. 84/2016.

62. Komisioneri Publik e kundërshtoi vlerësimin e Komisionit lidhur me këtë pasuri të paluajshme dhe shkaku e ngritur në ankimin e tij e mbështet në pretendimin se konkluzioni i Komisionit nuk qëndron, për sa kohë nuk bazohet në zbatimin e ligjit në situatën faktike dhe jurisprudencën e krijuar nga Kolegji, sikundër argumentuar prej tij edhe në lidhje me shkaku e ankimit lidhur me pasurinë e llojit “apartament banimi” me sip. 109,5 m², lidhur me deklarin e vlerës së likuiditeteve.
63. Në kundërshtimin e këtij shkaku të ankimit të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit në kundërankimin e tij, si dhe në parashtresat e tij para Kolegjit pretendoi se konkluzionet për mungesë burimesh vijnë si pasojë e mosmarrjes në konsideratë të gjithë kursimeve të tij në gjendjen *cash*. Subjekti pretendoi se, për shkak të njohurive të kufizuara në çështje të kontabilitetit, si dhe të mënyrës së konceptimit të kërkesave të formularit të deklarin, ka bërë disa gabime njerëzore në plotësimin e deklaratave të pasurisë, të cilat, sipas tij, nuk ndryshojnë thelbin e argumentimit të burimeve të nevojshme për investimet dhe shpenzimet e familjes së tij. Ai shpjegoi se në deklarin e gjendjes *cash*, nuk janë përfshirë dhe pasqyruar gjendjet në *cash* të krijuara nga tërheqja e kredisë në Bankën Raiffeisen, të cilat janë konsumuar për blerjen e një sipërfaqeje toke të ndodhur në Velipojë, me mendimin se ato janë të deklaruara një herë si burim të ardhurash, kur është deklaruar akordimi i kredisë.
64. Në shqyrtim të pretendimit të Komisionerit Publik lidhur me moszbatimin e duhur të ligjit për situatën faktike në rastin objekt gjykimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të përcjellë nga Komisioni dhe vlerësoi pretendimet e Komisionerit Publik mbi situatën faktike, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë shkaku ankimi, konstatoi si më poshtë.
- 64.1. Më datë 05.05.2011, subjekti i rivlerësimit ka përfituar një kredi konsumatore me hipotekë në Bankën Raiffeisen për shumën 2.200.000 lekë, e siguruar me pasurinë e tij: “Apartamentin me sip. 109,5 m²”. Pas disbursimit të kredisë, gjendja në llogarinë në Bankën Raiffeisen, në datën 31.12.2011, është në shumën 1.991.122 lekë, e deklaruar kjo gjendje likuiditeti në deklaratën e vitit 2011. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së pagës së subjektit në Bankën Raiffeisen, rezultoi se në datën 22.06.2011, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr në *cash* shumën 900.000 lekë, shumë e cila në të njëjtën ditë është depozituar në BKT për shlyerjen përfundimtare të kredisë pranë kësaj banke.

64.2. Në deklaratën periodike të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën: “Ndryshimet e interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, ka deklaruar: *Cash në shtëpi në shumën 500.000 lekë nga kursimet e pagave të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes. Gjendja e llogarisë në Bankën Raiffeisen është shtuar në shumën 2.000.000 lekë nga kredia e marrë pranë kësaj banke, në muajin maj 2010*²⁸.

64.3. Në datën 16.02.2012, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr në *cash* nga kjo llogari shumën prej 2.000.000 lekësh. Gjendja më datë 31.12.2012, në llogarinë në Raiffeisen Bank, është 102.237 lekë, e deklaruar kjo gjendje likuiditeti në deklaratën periodike të vitit 2012, ndërkohë në këtë deklaratë subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë deklaruar posedimin në *cash* në datën 31.12.2012, të shumës së tërhequr më datë 16.02.2012.

64.4. Në deklaratën periodike të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën: “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, ka deklaruar: *Gjendje në cash në shtëpi, në shumën 250.000 lekë, nga kursimet e pagave të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes. Gjendja e llogarisë në Raiffeisen Bank është në shumën 102.359 lekë, si kursime nga paga vjetore.*

64.5. Referuar akteve në dosjen e Komisionit, origjina e pasurisë “Tokë arë me sip. 379 m² “rrjedh nga kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.07.2013, lidhur midis shtetasve Rr. Rr.j dhe T. Rr., në cilësinë e shitësve, dhe subjektit të rivlerësimit Astrit Kalaja, në cilësinë e blerësit. Çmimi i shitjes së pasurisë është 1.800.000 lekë, shumë e deklaruar në kontratë kjo si e shlyer nga pala blerëse përpara datës së lidhjes së kësaj kontrate dhe jashtë zyrës noteriale.

64.6. Në deklaratën periodike të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën: “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, ka deklaruar: *Tokë arë me sipërfaqe 379 m² [...], e ndodhur në fshatin {***} Plazh Velipojë, rrethi Shkodër, e blerë me kredinë e marrë në Raiffeisen Bank, më datë 10.05.2011, në shumën 2.200.000 lekë, e deklaruar dhe në deklarin e vitit 2011.*

64.7. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni dhe njoftuar subjektit së bashku me rezultatet e hetimit administrativ, rezultoi se për vitin 2012, rezultati i analizës për këtë vit paraqitet me tepriçë pozitive në vlerën e 2.432.430 lekëve (pa përfshirë në këtë analizë edhe pakësimin e gjendjeve të llogarive bankare me vlerën prej 1.300.000 lekësh, të tërhequra nga llogaria e garancisë së kredisë, të cilat kanë qenë në dispozicion të subjektit të rivlerësimit, sa kohë detyrimi në të njëjtën vlerë i z. P. ishte deklaruar i shlyer²⁹), ndërkohë referuar të njëjtit dokument, subjekti i rivlerësimit ka pasur në vitin 2013 një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën prej 898.477 lekësh, për blerjen e pasurisë tokë arë në datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes.

- 65.** Në shqyrtim të fakteve dhe rrethanave të konstatuara si më sipër, trupi gjykues, duke vlerësuar mbi bazën e një analize të ardhurash dhe shpenzimesh referuar fakteve të provuara gjatë hetimit administrativ në Komision, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësinë e disponimit të një likuiditeti në gjendje *cash* në fund të vitit 2012, në vlerën e 3.732.430 lekëve, ndonëse kjo shumë apo pjesë e saj nuk rezultoi e deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2012, si shtim i likuiditetit në gjendje *cash* jashtë sistemit bankar. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi disponimin në gjendje *cash*, minimalisht të një pjese të këtij likuiditeti dhe konkretisht të shumës prej 2.000.000 lekësh të tërhequr nga llogaria bankare pranë Raiffeisen Bank, konfirmon faktin se

²⁸ Subjekti ka deklaruar vitin 2010, por referuar dosjes së përcjellë nga Banka Raiffeisen kredia rezulton e marrë në maj të vitit 2011 dhe referimi në vitin 2010 rezulton një lapsus i subjektit të rivlerësimit.

²⁹ Komisioni rezulton ta ketë trajtuar këtë shumë si pagesë për shlyerjen e pjesës së mbetur të huas ndaj z. Rr. P..

deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 pranë ILDKPKI-së nuk ka qenë i saktë, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar.

66. Megjithatë, trupi gjykues, në kuadër të arritjes së një vendimi të drejtë dhe objektiv lidhur me kontrollin e krijimit të pasurisë tokë arë me sip. 379 m², në Velipojë, pasi mori në konsideratë:

(i) diferencën e thellë mes vlerës së mundshme të kursimit për vitin 2012 dhe vlerës së pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë në vitin 2013;

(ii) faktin që rezultati pozitiv i analizës financiare të vitit 2012, vjen si rrjedhojë e ekzistencës së burimeve të ligjshme të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, të cilat janë deklaruar rregullisht, në mënyrë të plotë dhe të saktë në momentin e krijimit të tyre;

(iv) kohën relativisht të shkurtër nga momenti i tërheqjeve të likuiditetit nga llogaritë bankare deri në datën 31.12.2012, datë në të cilën është përlllogaritur vlera e kursimit të mundshëm, për të ngritur një dyshim të arsyeshëm te trupi gjykues në drejtim të shpenzimit të kësaj shume në tërësinë e saj. Ky vlerësim është bazuar jo vetëm në trendin e shpenzimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, përgjatë gjithë periudhës së marrë në analizë, por edhe për shkak të mungesës së të dhënave apo indicieve në drejtim të shpenzimeve të shtuara qoftë edhe vetëm në formën e dyshimit mbi ekzistencën e tyre, si rrjedhojë e ngjarjeve apo ndodhjeve të cilat mund të justifikonin krijimin e shpenzimeve;

(v) distancën relativisht të afërt nga momenti i fundit të vitit 2012, deri në përdorimin e këtyre kursimeve për financimin e blerjes së pasurisë tokë arë, e cila rezultoi të ketë ndodhur në intervalin 1 janar 2013 – 2 korrik 2013, duke qenë se në kontratë, pagesa e çmimit të tokës përcaktohet e shlyer para datës së nënshkrimit të saj; si dhe

(vi) faktin që deklarimi nga ana e subjektit për përdorimin e kredisë së disbursuar nga Banka Raiffeissen në vitin 2011, si burim për blerjen e pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sip. 379 m² në vitin 2013, nuk është një deklaram i posaçëm për nevojat e procesit të rivlerësimit kalimtar, por u provua të ketë qenë një deklaram i subjektit të rivlerësimit që në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, në momentin kur është krijuar pasuria objekt kontrolli dhe subjekti ndodhej para detyrimit ligjor të deklarimit të burimeve të krijimit të kësaj pasurie

– arriti në të njëjtin përfundim me Komisionin se, në rastin objekt gjykimi, për shkak të fakteve dhe rrethanave specifike si më sipër trajtuar, përfshirë edhe arsyetimin e Komisionit, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me burimin e krijimit të pasurisë së paluajtshme objekt kontrolli të llojit “tokë arë” me sipërfaqe 379 m² në deklaratën e pasurisë *vetting*, konsiderohen të besueshme dhe bindëse, për rrjedhojë, edhe pasaktësia e evidentuar në deklarimin e subjektit në deklaratën periodike të vitit 2012, për sa kohë nuk u provua të ketë shërbyer si një mjet për të justifikuar mungesë të burimeve të ligjshme, deklarim të rremë, fshehje pasurie apo situatë konflikti interesi dhe, për më tepër, rezultoi të jetë shëruar me deklarimin e burimit për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, që në deklaratën pasardhëse periodike të vitit 2013, nuk vlerësohet nga trupi gjykues si deklarim i pamjaftueshëm në kuptim të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

67. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues arriti në konkluzionin se shkak i ankimit të Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “tokë arë” me sipërfaqe 379 m², me vendndodhje në {***}-Plazh, Shkodër, gjendet i pabazuar në fakte dhe në ligj. Gjithashtu, trupi gjykues arriti në konkluzionin se faktet dhe rrethanat specifike të sipërcituara nuk mund të krahasohen dhe barazohen me situatën faktike të vendimmarrjeve të Kolegjit të përmendura nga Komisioneri Publik në ankimin e tij dhe, si pasojë, nuk mund të shërbejnë si bazë për kontrollin e vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi për vlerësimin e kësaj pasurie. Për rrjedhojë, vlerësimi i Komisionit lidhur me kontrollin e kësaj pasurie të subjektit të rivlerësimit gjendet i drejtë dhe i bazuar.

68. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pas verifikimit të situatës faktike nëpërmjet analizës dhe çmuarjes së provave të administruara gjatë procesit të hetimit nga Komisioni, akteve të administruara gjatë hetimit gjyqësor në Kolegj, dëgjimit të parashkrimeve të palëve në seancë gjyqësore publike, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, sipas parashkrimeve në fuqi në kohën në të cilën kanë ndodhur faktet e provuara gjatë hetimit, trupi gjykues, bazuar në analizën e mësipërme, arriti në përfundimin se shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, lidhur me pasuritë objekt kontrolli, sipas këtij gjykimi, nuk bazohen në faktet juridike të vërtetuara nga gjykimi i kësaj çështjeje dhe zbatimi i ligjit mbi to.
69. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se konkluzionet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit lidhur me kriterin e pasurisë janë të drejta dhe të bazuara në fakte dhe në ligj. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit Astrit Kalaja çmohet se ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të parashkrimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
70. Për vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, sipas vendimit të Komisionit, ka rezultuar se ka një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.
71. Për rrjedhojë, trupi gjykues, në vijim të konkluzioneve të mësipërme, bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vlerësoi se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për rrjedhojë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 224, datë 20.12.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Astrit Kalaja.
 2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
- U shpall sot, më datë 27.01.2022, në Tiranë.

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi – kundër

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtarja Rezarta Schuetz, votova kundër vendimit të shumicës që konfirmoi në detyrë subjektin e rivlerësimit Astrit Kalaja dhe la në fuqi vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) për këtë subjekt [vendimi nr. 224, datë 20.12.2019]. Në vlerësimin tim, vendimi i Komisionit do të duhej të ishte ndryshuar dhe subjekti të shkarkohej nga detyra për deklaram të pamjaftueshëm, parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për të njëjtat shkaqe, pretendimet e Komisionerit Publik ishin të drejta dhe duheshin pranuar.
2. Nëpërmjet ankimit të tij dhe në përfundim të procesit gjyqësor në Kolegj, Komisioneri Publik kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit, pasi subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë. Pretendimet e Komisionerit Publik, në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit, përqendrohen mbi dy pasuri në pronësi të subjektit: një apartament me sipërfaqe 109,5 m² në Shkodër dhe një tokë arë në {***}-Plazh [Velipojë, Shkodër] me sipërfaqe 379 m², lidhur edhe me likuiditetet jashtë sistemit bankar ndër vite që kanë shërbyer për të financuar blerjen e këtyre pasurive.
3. Vlerësoj që arsyetimi i Komisionerit Publik për problematikën që paraqet vlerësimi i kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit, është i bazuar në ligj dhe në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit. Arsyetimi im vijon sipas shkaqeve të ankimit, për lehtësi reference.

I. Pasuria e parë – deklaram i pasaktë dhe i pamjaftueshëm dhe mungesë burimesh të ligjshme

4. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimet e tij në zbatim të përcaktimeve të paragrafit 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe gjendet në kushtet e parashikuara në paragrafët 3 dhe 5 të së njëjtës dispozitë për këtë pasuri, si dhe ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm për shkak se (i) nuk ka deklaruar marrëdhënien e huas me një individ [z. Rr.P.], mundësia e të cilit për të dhënë huan me burime të ligjshme nuk është provuar. Po ashtu, sipas Komisionerit Publik, subjekti është në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme edhe për të shlyer këstin e dytë të apartamentit në maj 2009, në vlerën 1,679 milionë lekë.
5. Nga aktet në fashikull, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet një depozitimi në *cash* nga një individ [z. Rr.P.], ka përfituar fonde në vlerën 3,3 milionë lekë. Si pasojë e këtij transaksioni të formalizuar edhe në deklaramen noteriale të hartuar nga z. P., në të cilën subjekti i rivlerësimit është cilësuar “debitor”³⁰, ky i fundit ka përfituar shumën në fjalë, të cilën e ka transferuar drejt një llogarie bankare tjetër të tijën, si garanci. Sipas Komisionerit Publik, z. P. paraqitet në cilësinë e huadhënësit në kuptim të nenit 32, pika 4³¹ e ligjit nr. 84/2016, pasi marrëdhënia plotëson kushtet e një huaje sipas përcaktimeve të Kodit Civil, dhe ka qenë në pamundësi të jepte huan me burime të ligjshme. Për më tepër, Komisioneri Publik vlerëson edhe që burimi i krijimit të shumës prej 3,3 milionë lekësh u deklarua në mënyrë kontradiktore. Si pasojë, subjekti krijoi paqartësi jo vetëm në drejtim të identifikimit të huadhënësit *real*, por edhe të verifikimit të mundësisë financiare për të mbuluar shumën me burime të ligjshme.

³⁰ Deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.12.2007, hartuar në prezencë të subjektit të rivlerësimit.

³¹ Neni 32 pika 4 e ligjit nr. 84/2016 thotë: “[...] 4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive [...]”.

6. Nga aktet rezulton që subjekti ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë objekt analize (i) një kredi bankare dhe (ii) shitjen e një apartamenti në Shkodër [me sipërfaqe 63 m²]. Kredia është siguruar nëpërmjet hipotekimit të apartamentit prej 63 m², në shkurt 2007. Në dhjetor 2007, subjekti ka ndryshuar sigurimin e kredisë, duke depozituar si garanci bankare shumën prej 3,3 milionë lekësh, të cilën tri ditë më herët (shih edhe paragrafin 5 më sipër) e kishte depozituar në *cash* z. Rr.P. në llogarinë rrjedhëse të subjektit të rivlerësimit, me përshkrimin “për garanci shlyerje kredie”. Subjekti e ka transferuar të njëjtën shumë në llogarinë e garancisë “për kolateral për kredinë”. Këto veprime nuk janë deklaruar asnjëherë nga subjekti gjatë deklaramëve periodike vjetore. Për herë të parë, kjo marrëdhënie është deklaruar në deklaratën e pasurisë [vetting], me cilësimin e përfundimit të marrëdhënies për shkak të shlyerjes së kredisë, si dhe duke ia atribuuar mbështetjen nga z. P. edhe një personi juridik me të cilin ka marrëdhënie pune z. P. në “veprimtarinë e tij ekonomike”³². Vetë subjekti e ka deklaruar këtë marrëdhënie në rubrikën që kërkon të dhënat për personat e lidhur. Subjekti nuk ka deklaruar si dhe në çfarë mënyre e ka shlyer këtë detyrim ndaj z. P..
7. Gjatë hetimit të kryer në Komision, subjekti ka qenë kontradiktor në lidhje me identitetin e huadhënësit real, fakt që në vlerësimin fundor, në vetvete përbën pasaktësi në deklaram, por edhe pamundëson vlerësimin e burimeve të ligjshme në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, veprime që janë në mospërputhje të hapur me detyrimet e përcaktuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës³³, për sa u përket burimeve të krijimit të pasurive. Konkretisht, subjekti ishte kontradiktor në pretendimet e tij në hetim përkundër sa ka referuar në deklaratën e pasurisë në saktësimin nëse ishte vetë personalisht z. P., “lidhje miqësore” e subjektit, personi juridik {***} ShPK, apo të dyja këto burime, që kanë kontribuar me fondet prej 3,3 milionë lekësh, duke rënë ndesh kështu me deklaramin e tij në deklaratën e pasurisë vetting. Subjekti po ashtu pretendoi që marrëdhënia me z. P. nuk përbënte huadhënie.
8. Në përmbledhje, nga aktet dhe hetimi rezulton se subjekti ka (i) garantuar kredinë me një shumë të ngurtësuar në dispozicion të tij nga një individ i cili “mbështetet” financiarisht nga një person juridik, (ii) ky veprim nuk është deklaruar për nëntë (9) vite, me gjithë detyrimin që subjekti kishte për deklaram të detyrimeve financiare sipas nenit 4, germa “dh” e ligjit nr. 9049/2003, (iii) në kushtet kur u vu në pikëpyetje mundësia e z. P. për të mbuluar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua subjektit të rivlerësimit dhe mbështetja financiare e huadhënësit nga shoqëria {***} ShPK – pretenduar prej huadhënësit edhe në një deklaratë noteriale të vitit 2014³⁴, por edhe prej subjektit në deklaratën e pasurisë vetting – subjekti mohoi “mbështetjen” e pretenduar nga shoqëria {***} ShPK gjatë përgjigjeve të pyetësorëve. Në këta të fundit, subjekti e cilësoi situatën faktike si “asnjë lidhje me {***} ShPK për garantimin e kredisë” dhe që “përfshirja e lokalit berrari në kapitalin themeltar të {***} ShPK”, deklarata noteriale e z. P. dhe vërtetimi i shoqërisë në funksion të konfirmimit të lokalit berrari në kapitalin themeltar të shoqërisë, përbëjnë “gabim”.
9. Shumica e trupit gjykues vlerësoi që subjekti duhet të justifikojë burimet e ligjshme për huan nga z. P. vetëm në vlerën 1,3 milionë lekë, meqenëse vlera tjetër, prej 2 milionë lekësh, e marrë hua “nuk rezulton të jetë futur në qarkullim nga ana e subjektit të rivlerësimit”. Vlerësoj që ky interpretim është i pabazuar në

³² Tekstualisht, subjekti ka deklaruar mbështetjen dhënë z. P. nga të tjerë si vijon: “[...] Personi juridik “{***}” shpk [...] lgi. D. [...] ka ndikuar ne [garantimin e kredise duke mbeshtetur Rr. Z. P. (S.) ne veprimtarine e tij ekonomike [...]”. Faqe 8, deklarata e pasurisë.

³³ Paragrafët 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikojnë shprehimisht: “[1.] Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. [...] Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet [...] të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

³⁴ Deklarata noteriale {***}, datë 23.10.2014, nga z. Rr. P. dhe vërtetimi i lëshuar nga administratori i {***} ShPK, më 21.10.2014 dhe 24.10.2016.

ligj, por edhe në rrethanat faktike konkrete. Së pari, sepse neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 nuk bën dallim cilësor apo sasior mes destinacionit për të cilin përdoret një hua apo dhurim. Për sa kohë provohet marrëdhënia e huas, në procesin e rivlerësimit, ligji e shoqëron atë me detyrimin për justifikimin e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur. Fragmentarizimi sasior i huas, që shoqërohet me detyrime të reduktuara të subjektit të rivlerësimit në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, meqenëse në pamje të parë rezulton që subjekti ka poseduar shuma të ndryshme në kohë të ndryshme, nuk është i bazuar në ligj. Për sa kohë një person tjetër i lidhur shfaqet në cilësinë e huadhënësit, huaja duhet të justifikohet me burime të ligjshme. Fati i një pjese apo të gjithë fondeve pas momentit kur krijohet cilësia e personit tjetër të lidhur, është artific pasi nuk është produkt i shkronjës apo frymës së ligjit. Së dyti, nëse subjekti nuk do të posedonte këtë shumë në dhjetor 2007, ai do ta kishte të pamundur të çlironte nga barra dhe për pasojë të shiste apartamentin prej 63 m², nga i cili gjeneroi gjithë vlerën në *cash* që rezulton të ketë përbërë nevojë të ngutshme nëse merret në konsideratë tërheqja nga banka e gjithë shumës në javët pas pagesës nga shitësi dhe shpenzimet e tjera të kryera në vitin 2008, të pranuar nga subjekti. Me fjalë të tjera, edhe pretendimi që një pjesë apo e gjithë shuma e huas nuk ka prodhuar pasuri për subjektin, apo që dhe as ky i fundit nuk ka deklaruar të ketë krijuar pasuri, nuk qëndron. Subjekti ka krijuar mundësinë të posedonte 3,5 milionë lekë në *cash* për periudhën prill – maj 2008, në saje të huas, likuiditet nga i cili rezulton të jetë shpenzuar minimalisht vlera 1 (një) milionë lekë.

10. Interpretimi formalist i shumicës bie ndesh edhe me arsyet për të cilat në procesin e rivlerësimit kalimtar ligjberësi ka përcaktuar qartë detyrime për individët dhe personat juridikë që paraqiten në cilësinë e kontribuuesit në drejtim të krijimit të pasurive dhe të ardhurave për subjektet e rivlerësimit. Në procesin e rivlerësimit, subjektet duhet të provojnë ligjshmërinë e burimeve me anën e të cilave personat e tjerë të lidhur kanë ndihmuar materialisht subjektet e rivlerësimit “me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht”. Ky përcaktim nënkupton detyrimin që, në mënyrë që pasuritë të konfirmohen si të krijuara me burime të ligjshme, institucionet e rivlerësimit duhet të kenë përjashtuar së pari mundësinë që pasuri të subjekteve të rivlerësimit, të krijuara në forma të paligjshme, të evitojnë kontrollin në mbulesën e dhuratës apo huas nga palë të treta.
11. Për sa më sipër, vlerësoj se subjekti duhet të provonte me burime të ligjshme të gjithë vlerën prej 3,3 milionë lekësh që z. P. i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit. Nga analiza financiare, rezulton që ai [z. P.] është në pamundësi financiare për të mbuluar me burime të ligjshme shumën e depozituar në llogarinë financiare të subjektit. Sjell në vëmendje që nuk rezultojnë të dokumentuara as transaksione të kryera nga z. P. apo bashkëshortja e tij në momentin dhe në vlerën e huas së dhënë. Nuk ka gjurmë dokumentare të shlyerjes së gjithë huas nga subjekti, përfshirë edhe deklaratimet periodike vjetore të plotësuara nga subjekti sipas ligjit nr. 9049/2003. Në përmbledhje, vetë z. P. nuk ka burime të ligjshme për të dhënë shumën e *cash*-it të depozituar në llogarinë bankare të subjektit dhe as ka dokumentuar lëvizjen bankare të këtyre të ardhurave. Asnjë e dhënë dokumentare nuk tregon mundësinë apo historikun e posedimit dhe lëvizjes së këtyre të ardhurave, përveç faktit që ato janë gjendur në llogarinë bankare të subjektit në një ditë të caktuar.
12. Në këto kushte, qasja e shumicës që anashkalon natyrën e vërtetë të rrethanave faktike të cilat nuk lenë vend për dilema, është e gabuar pasi anashkalon logjikën e ftohtë duke e fokusuar analizën në sasinë e parave që kanë hyrë e dalë nga llogaria e subjektit pasi ka marrë huan, dhe në këtë mënyrë redukon detyrimet e subjekteve të rivlerësimit, edhe përkundër fakteve të pakontestueshme siç janë vlerat e huas, duke cenuar qëllimin e ligjit.
13. Sjell në vëmendje që vlerësimi im bazohet edhe në faktin që shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe në kufijtë e alogjizmit ekonomik. Së pari, sepse nëse marrëdhënia miqësore me huadhënësin ekzistonte minimalisht në dhjetor 2007 [koha kur është dhënë huaja nga z. P.], logjika e thjeshtë ekonomike do të diktonte që nëse disponohet një shumë për të cilën nuk paguhet interes dhe e barabartë me kredinë, të shlyhej kjo e fundit duke evituar interesat, të çlirohej apartamenti 63 m² nga kolaterali dhe të ardhurat nga shitja të ishin në dispozicion për nevoja të ndryshme financiare, përfshirë edhe investim nëpërmjet institucioneve financiare. Në fakt, rrjedha e veprimeve siç i përshkruan ato subjekti, nuk ka qenë logjike,

përkundrazi. Subjekti pretendon që ka marrë një fond nga z. P. [huan], të cilin e ka ngurtësuar në bankë, për të vazhduar të shlyente ndër vite një hua tjetër [kredia bankare] me interesa mujorë, ndërkohë që të ardhurat nga shitja e apartamentit 63 m² i tërhoqi thujse menjëherë pasi i përfitoi, duke i mbajtur *cash* jashtë sistemit bankar – dhe përjashtuar që nëpërmjet tyre të krijohej ndonjë përfitim financiar. Nga konfermat bankare në fashikull, rezulton se në periudhën mes 21 prill dhe 6 maj 2008, subjekti ka tërhequr në *cash të gjithë* shumën e përfituar nga shitja e apartamentit që më parë ishte kolateral. I vetmi shpjegim logjik që rezulton nga veprimet e mësipërme, është që subjekti kishte nevojë për *cash* në periudhën në fund të vitit 2007 deri në gjysmën e vitit 2008.

14. Subjekti nuk ka shpjeguar destinacionin e këtyre fondeve apo arsytet për të cilat i nevojitej në *cash*, jashtë sistemit bankar, brenda një muaji, e gjithë vlera [3,5 milionë lekë] e përfituar nga shitja e apartamentit. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, subjekti ka deklaruar 400 mijë lekë *cash kursime nga pagat* e tij dhe të bashkëshortes, në shtëpi. Për *cash*-in nga shitja e apartamentit nuk ka deklarim. Në procesin e hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar shpenzime mjekësore në vitin 2008, në vlerën 1 (një) milion lekë. Këto fakte, të referuara nga subjekti në hetimin administrativ – me gjasa për të përmirësuar pozitën e tij gjatë rivlerësimit – do të duhej të ishin vlerësuar nga Komisioni dhe shumica e trupit gjykues të Kolegjit për të përjashtuar nëse ishin vetëm një pjesë e një të tërë shpenzimesh të tjera, dhe efekti i shpenzimeve të tjera gjatë vitit 2008 të vlerësohej përkundër mundësisë së pagesës së kështit të dytë të apartamentit objekt analize me burime të ligjshme. Në mungesë të burimeve të ligjshme të mjaftueshme, subjekti gjendet minimalisht në kushtet e deklarimit të rremë për burimet që kanë shërbyer për të shlyer kështin e dytë të apartamentit me sipërfaqe 109,5 m², që në pikën fundore do të duhej të ishte pjesë e analizës nëse subjekti është i përshtatshëm në kriterin e vlerësimit pasuror.
15. Të gjitha këto rrethana u pranuan nga shumica, pavarësisht se bien ndesh me logjikën e thjeshtë: subjekti nuk shpjegoi bindshëm asnjëherë përse kreu hapa shtesë pa arsye logjike financiare. Faktet janë si vijon: një individ depozitoi *cash* në sasi të konsiderueshme [3,3 milionë lekë] në llogarinë e subjektit. Krijimi i *cash*-it me burime të ligjshme ishte i pamundur. Këto fonde “ngrinë” nga dhjetori 2007 deri në 8 qershor 2010, ndërkohë që subjekti zgjodhi të përballonte barrën e konsiderueshme të interesave të kredisë, megjithëse kishte para të disponueshme pa interes në saje të lidhjes “miqësore” [me z. P.], teksa – siç pretendon subjekti dhe pranon shumica – mbante paratë e përfituara nga shitja e një shtëpie jashtë sistemit bankar.
16. Në të njëjtën situatë, atë të pamundësisë së mbulimit me burime të ligjshme, subjekti gjendet edhe për sa i përket pagesës së shlyerjes së kredisë së marrë nga BKT-ja. Më 26 mars 2010, subjekti ka depozituar *cash* vlerën prej 2 milionë lekësh, për mbyllje të pjesshme të kredisë nga BKT-ja. Totali i kursimeve të deklaruara nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2009, rezulton në më pak se 1 (një) milion lekë. Pranimi nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, sikurse edhe nga Komisioni, i ekzistencës së fondeve në *cash*, jashtë sistemit bankar (në shtëpi) nga maji 2008 deri në mars 2010, [shtjelluar në paragrafët 14 dhe 15], të padeklaruara në deklaratat periodike vjetore të plotësuar nga subjekti³⁵, është në kundërshtim me përcaktimin e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016,³⁶ sikurse bie ndesh edhe me jurisprudencën e Kolegjit.
17. Dispozita në fjalë përcakton që deklaratat periodike të subjekteve ndër vite kanë vlerë provuese në procesin e rivlerësimit. Po ashtu, Kolegji ka konsoliduar qëndrimin e tij nëpërmjet jurisprudencës për të konfirmuar që pretendimet gjatë procesit të rivlerësimit për likuiditete të disponuara ndër vite, nuk janë bindëse për sa kohë nuk konfirmohen me deklaratimet në deklaratat periodike vjetore. Kjo mënyrë arsyetimi ka gjetur

³⁵ Referuar nenit 4, pika 1, shkronja “d” e ligjit nr. 9049/200339, zyrtarët deklarues detyrohen të deklarojnë, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare, si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...].

³⁶ Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 përcakton: “[...] 5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit”.

pasqyrim në çështjet që u përkasin subjekteve E. Islamaj [JR 11/2018], E. Sadiku [JR 07/2019], Xh. Zaganjori [JR 19/2019], G. Osmani [JR 20/2019], F. Qato [29/2019], D. Peka [27/2020], A. Martini [JR 13/2021], ndër të tjera. Në të gjitha këto çështje, referuar edhe nga Komisioneri Publik në ankimin e tij kundër vendimit objekt kontrolli³⁷, trupa të ndryshëm gjykues të Kolegjit kanë theksuar vlerën provuese që kanë deklarimet e subjekteve ndër vite, sidomos për sa u përket likuiditeteve jashtë sistemit bankar dhe që mungesa e përvojës në plotësimin e deklarimeve periodike vjetore referuar nga subjektet, është një kriter i pabazuar në ligj, por edhe në rrethanat specifike të njohurive ligjore dhe përvojës së subjekteve si magjistratë për njohjen dhe zbatimin e ligjit.

18. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit për pagesë të kështit të kredisë me *cash*-in e padeklaruar, ishte i pabazuar në ligj dhe, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit, në kushtet e shpjegimeve jobindëse të subjektit, shtjelluar më sipër, nuk duhej të ishte pranuar. Për të njëjtat arsye, vlerësoj që pretendimi i Komisionerit Publik është i drejtë dhe duhej të ishte pranuar lidhur me pasurinë objekt analize. Subjekti i rivlerësimit Astrit Kalaja ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe është në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

II. Pasuria e dytë – deklarim i pasaktë dhe i pamjaftueshëm

19. Shkaku i dytë i ankimit të Komisionerit Publik lidhet me një pasuri të paluajtshme të subjektit në {***}-Plazh, Velipojë, tokë me sipërfaqe 379 m². Komisioneri Publik argumentoi që subjekti ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm dhe është në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie [në vitin 2013], rrethana të parashikuara respektivisht në dispozitat e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
20. Votova kundër shumicës edhe për këtë shkak ankimi, pasi çmoj se edhe këto pretendime të Komisionerit Publik duhej të ishin pranuar si të bazuara në ligj dhe në logjikën e fakteve. Nga ana tjetër, subjekti nuk provoi ekzistencën e të ardhurave me burime të ligjshme të mjaftueshme që mund të kishin qenë në dispozicion të tij për të justifikuar teorikisht mundësinë financiare. Subjekti nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh jashtë sistemit bankar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, gjë që do të mund të justifikonte teorikisht disponimin e të ardhurave prej tij në momentin kur është kryer blerja, në gusht 2008. Përkundrazi, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, subjekti ka deklaruar si të vetmen gjendje *cash* në banesë kursimet prej 250 mijë lekësh. Ndërkohë, si burim krijimi i kësaj pasurie referohet një kredi konsumatore, e marrë mbi dy vjet më herët nga Raiffeisen Bank. Konkretisht, kredia është disbursuar në llogarinë e tij në 5 maj 2011, subjekti ka tërhequr 900 mijë lekë një muaj më pas për të paguar kredinë tjetër BKT-së e së fundmi, më 16 dhjetor 2012, ka tërhequr thuajse të gjithë shumën në *cash*. Subjekti nuk ka deklaruar se e posedonte këtë shumë më 31 dhjetor, në deklaratën periodike për vitin 2012.
21. Gjatë hetimit administrativ dhe procesit gjyqësor në Kolegj, subjekti i cilësoi të gjitha mospërputhjet si pasaktësi dhe gabime që ai ka kryer gjatë plotësimit të deklaratave periodike vjetore. Shumica e pranoi këtë argument të subjektit. Sjell në vëmendje që edhe Komisioni rezulton të ketë zgjedhur një mënyrë vlerësimi sipas së cilës pretendimet e subjektit në procesin e rivlerësimit janë bindëse, ndonëse ato bien ndesh me deklarimet e tij ndër vite, të cilat kanë vlerë provuese. Me fjalë të tjera, pavarësisht se dokumentet zyrtare

³⁷ Ndër të tjera, në faqen 9 të ankimit: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2020/02/30.Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-224-dat%C3%AB-20.12.2019-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%ABr-subjektin-e-rivler%C3%ABsimit-z.-Astrit-Kalaja.pdf> dhe në faqet 1, 2 dhe 5 të parashtrimeve të datës 25 janar 2022 në seancën publike në Kolegj në: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2020/02/Parashtrimet-e-%C3%A7%C3%ABshtjes-dat%C3%AB-25.1.2022.pdf>.

të hartuara ndër vite kanë vlerë provuese, Komisioni ka vendosur t'i injorojë ato dhe ta bazojë vlerësimin e tij në pretendimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit dhe në funksion të përmirësimit të situatës së tij. Duke u nisur nga premisa që deklaratat periodike vjetore kanë vlerë provuese, megjithëse në rastin konkret Komisioni preferon të mos i marrë në konsideratë, do duhet të pranohen në mënyrë prapavepruese edhe deklaratimet e kryera nga subjekti në funksion të justifikimit të krijimit të një pasurie, interpreton Komisioni. Pra, pavarësisht se ligji u ka dhënë vlerë provuese shprehimisht deklaratave periodike vjetore, Komisioni i lë ato mënjane për të shtrirë vlerën provuese të deklaratimeve të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, duke vepruar si ligjbërës, në kushtet kur u jep vlerë provuese në mënyrë selektive deklaratimeve të subjektit, duke u dhënë peshën në përputhje me konkluzionin përfundimtar, ndërkohë që pesha dhe kredibiliteti i deklaratimeve duhet të jenë baza mbi të cilën mbështetet vendimi përfundimtar, jo e anasjella.

22. Nuk isha dakord dhe votova kundër shumicës së trupit gjykues të Kolegjit po ashtu pasi vërej që, ndonëse konstatuan se subjekti nuk ka deklaruar kursime në fund të vitit 2012 të cilat do të mundësonin teorikisht investimin në pasuri, zgjodhën të konstatojnë gjithsesi mjaftueshmëri burimesh të cilat vetë subjekti nuk i ka deklaruar. Qëndrimi i shumicës dhe Komisionit që pranon pretendimin e subjektit, bie ndesh me përcaktimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, e cila dikton që vendimi i marrë dhe bindja e brendshme e institucioneve të rivlerësimit të mbështetet “[...] vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera [...]”.
23. Megjithëse nga momenti kur likuiditetet ishin tërhequr nga banka dhe ekzistenca e tyre e pjesshme – e pamjaftueshme për të krijuar pasurinë e dytë – ka lënë gjurmët e fundit, e deri në pretendimin e përdorimit të tyre kanë kaluar 7 muaj, shumica argumenton që fondet duhet të kenë qenë në disponim pasi trendi i shpenzimeve të subjektit e justifikon, sikurse edhe mungesa e indiceve për pasuri të tjera apo fshehje. Në vlerësimin tim, në mungesë të akteve që do të dokumentonin ekzistencën e këtyre fondeve dhe faktit që tërheqja e fundit nga banka përbën vetëm një pjesë të vlerës së pasurisë tokë, ekzistenca e këtyre fondeve në momentin e krijimit të pasurisë në gusht 2013 është e pamundur të konfirmohet, ndërsa pretendimi i subjektit mbeti në nivel deklarativ. Po ashtu, sjell në vëmendje trendin e subjektit për të disponuar likuiditete jashtë sistemit bankar në sasi të mëdha në mënyrë të qëndrueshme, minimalisht në vitet e marra në analizë. Ky fakt i vetëm dobëson bindjen e shumicës për mungesën e indiceve për pasuri apo shpenzime të tjera.
24. Siç shtjellohet gjerësisht më sipër në lidhje me shkakun e parë të ankimit, edhe në lidhje me këtë pasuri, qëndrimi i shumicës së trupit gjykues të Kolegjit [dhe Komisionit] bie ndesh edhe me jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit lidhur me *cash*-in jashtë sistemit bankar dhe vlerën e pazëvendësueshme provuese që merr, për këtë shkak, saktësia e deklaratimeve dhe gjurmët në formën e akteve dokumentare [shih edhe paragrafin 17 më sipër]. Si shembull, në vlerësimin tim, mbështetem, ndër të tjera, në një situatë të ngjashme faktike dhe ligjore – në çështjen që i përket rivlerësimit të subjektit A. Martini. Në vendimin e Kolegjit në atë çështje, në paragrafin 54, trupi gjykues ka arsyetuar që:

“[...] Mosdeklarimi i vlerave [...] në deklaratimet e interesave privatë, si shtesa të likuiditeteve *cash* në banesë, në fund të viteve 2007 dhe 2008, e më tej në asnjë prej viteve në vijim, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, krijon bindjen se këto shuma nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për investimet [...] në vitet 2013 e 2014, tërheqja e të cilave në vitin 2015 është pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi për pagesën e kështit të parë për blerjen pasurisë “apartment” në po të njëjtin vit [...]”.

25. Pavarësisht se në rastin e sipërcituar periudha kohore pas së cilës likuiditetet e pretenduara të ruajtura jashtë sistemit bankar ishte më e gjatë, periudha kohore në rastin e subjektit në shqyrtim është me rëndësi dytësore, për sa kohë mbetet fakt i pakontestueshëm tërheqja e fondeve/likuiditeteve nga banka, mosdeklarimi i ekzistencës së tyre në deklaratën periodike vjetore dhe totali i vlerës së disponueshme nga kjo tërheqje, shtjelluar më sipër, që përbën vetëm një pjesë të vlerës së pasurisë së pretenduar se është krijuar me atë burim.

26. Shumica arsyeton që, meqenëse subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësinë e disponimit të një likuiditeti në gjendje *cash* në fund të vitit 2012, në vlerën e 3.732.430 lekëve, do të pranohet pretendimi i subjektit për burime të ligjshme të mjaftueshme, megjithëse likuiditetet nuk janë deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2012 si shtim i likuiditetit në gjendje *cash* jashtë sistemit bankar. Ky qëndrim i shumicës, i cili pranon pretendimet e subjektit bazuar në mundësinë e disponimit të likuiditeteve të padeklaruara³⁸, bie ndesh edhe me një vendimin orientues të Kolegjit, sipas të cilit Komisioni udhëzohet:

“[...] të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike [...].

[...] për sa kohë në deklaratën periodike të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë këto kursime dhe as si pakësim të gjendjes *cash* të deklaruar në vitet 2006 dhe 2007, në shumën totale prej [...] lekësh, Komisioni pa asnjë arsye të ligjshme e ka prezumuar përdorimin e këtij likuiditeti në vitin 2013, gjatë të cilit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka krijuar pjesën më të madhe të pasurisë së tij, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*³⁹”.

27. Parë në tërësi, të gjitha këto elemente më kanë çuar në përfundimin që pretendimi i subjektit dhe deklarimi i tij në deklaratën e pasurisë për destinacionin e kredisë së marrë në drejtim të krijimit të pasurisë tokë, përbëjnë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm edhe për këtë pasuri. Subjekti gjendet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve për krijimin e pasurisë.
28. Për sa më sipër, vlerësoj se pretendimi i Komisionerit Publik duhej të ishte pranuar. Subjekti i rivlerësimit Artur Kalaja nuk plotëson kushtet e përcaktuara nga neni 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016⁴⁰ dhe nuk duhej të ishte konfirmuar në detyrë pasi nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

³⁸ Shih paragrafët 65 dhe 66 të vendimit të shumicës.

³⁹ Vendimi që i përket subjektit të rivlerësimit E. Sadiku [JR 26/2018], paragrafët 37 dhe 39.

⁴⁰ “[...] 1. Konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet e mëposhtme: a) kur arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë [...]”.